



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VOĐE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



## Raporti i Punës për Vitin – 2023

---

Mars 2024

## PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>2</b>
<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. KORNIZA LIGJORE.....</b>	<b>6</b>
2.1 SFIDAT LIGJORE ME TË CILAT BALLAFAQOHET ARRU .....	6
<b>3. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I ARRU .....</b>	<b>8</b>
3.1 MISIONI DHE VIZIONI I ARRU-SË.....	8
3.2 VIZIONI.....	8
3.3 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË .....	8
<b>4. FUSHËVEPRIMI I ARRU .....</b>	<b>9</b>
4.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARRU .....	11
4.2 BORDI I DREJTORËVE .....	13
4.3 EKZEKUTIVI I ARRU.....	13
4.4 BURIMET NJERËZORE.....	14
4.5 ASETET .....	14
<b>5. AKTIVITETET PËR PERIU DHËN RAPORTUESE .....</b>	<b>16</b>
5.1 AKTIVITETET E REALIZUARA NË VITIN 2023 .....	16
<b>6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>43</b>
<b>7. RAPORTI FINANCIAR.....</b>	<b>45</b>
7.1 TË HYRAT .....	45
7.2 BUXHETI .....	45
7.3 SHPENZIMET BUXHETORE .....	46
<b>8. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....</b>	<b>47</b>
<b>SHTOJCA 1: TË DHËNAT E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT .....</b>	<b>48</b>
SH-1.1: ANKESAT DHE NATYRA E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE .....	48
SH-1.2: TREGUESIT E PERFORMANCËS TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT .....	50
<b>SHTOJCA 2: TARIFAT PËR UJË DHE UJËRA TË NDOTUR .....</b>	<b>60</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

ARRU	– Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	– Bordi i Drejtorëve të KRU-ve
IKSHPK	– Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IAWD	– Shoqata Ndërkombëtare e Ujit të Danubit
IBNET	– Rrjeti Ndërkombëtar i Bechmarkingut
NJPMNP	– Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
Nj-I	– Njësia për inspektim
KNMU	– Këshilli Ndërministror për Ujërat
ME	– Ministria e Ekonomisë
MIE	– Ministria e Integriteteve Evropiane
MEF	– Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPHI	– Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MTIN	– Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë
KRU	– Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit
KK	– Komisioni Funkcional Parlamentar i Kuvendit të Kosovës
KZA	– Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave
UPF	– Uji i Pa Faturuar
PMA	– Plani i menaxhimit të aseteve
PB	– Plani i Biznesit
D-ÇL&L	– Departamenti për çështje ligjore dhe licencim
D-RP	– Departamenti për raportim dhe performancë
D-AF	– Departamenti për administratë dhe financa
D-T	– Departamenti për tarifa
DANUBIS	– Programi i Bechmarkingut të Vendeve të Regjionit të Danubit
ERRU	– Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë
QK	– Qeveria e Kosovës
QRSHP	– Qendrat Regjionale të Shëndetit Publik
GIS	– Sistemi informativ gjeografik
SCO	– Zyra Zvicerane për Zhvillim
SHUKOS	– Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
SKZH	– Strategjia kombëtare për zhvillim
ZD	– Zëvendës Drejtori i ARRU
ZMP	– Zyrtar për Marëdhënie me Publikun
WAREG	– European Water Regulators (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit)

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU), sipas Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjit nr. 06/l - 088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është Autoritet i pavarur me mandat për rregullimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të ujit (të pijshëm), të ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Roli dhe mandati i ARRU është që të monitorojë dhe të sigurojë që Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të) ofrojnë shërbime cilësore, efçente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh para së gjithash mbrojtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

ARRU ka përgjegjësinë edhe për të zhvilluar dhe avancuar kornizën rregullatore, plotësimin dhe avancimin me standarde të reja për të siguruar që Kompanitë Rajonale të Ujësjes të licencuara të ofrojnë furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura në mënyrë efikase dhe me kosto të përballueshme për të gjithë konsumatorët brenda zonës së shërbimit.

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara të ARRU gjatë vitit 2023 (1 Janar 2023 deri 31 Dhjetor 2023) - të 4 departamenteve dhe njësisë së inspeksionit. Në shtojcë të raportit jepen të përmbledhura në formë tabelash apo grafikonesh disa të dhëna që ilustronë performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit & ujërave të ndotur, tarifave e aplikueshme për vitin kalendarik 2023 dhe raportin financiar të ARRU-së.

Përveç obligimit ligjor për hartim dhe dorëzim të Raportit Vjetor të Punës së ARRU-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ky raport synon të jetë një burim shtesë informacioni për publikun dhe palët e interesit. ARRU, në kuadër të mandatit të saj ligjor, publikon të gjitha raportet, urdhëresat dhe të dhënat tjera lidhur me aktivitetet dhe performancën e sektorit në web-faqen e saj <http://www.arru-rks.org>.

Përkundër të gjitha sfidave dhe vështirësive, ARRU falë angazhimit të stafit të saj dhe bashkëpunimit të mirë me KRU-të dhe palët tjera të interesit, ka arritur të realizojë obligimet e saj ligjore dhe të përmbushë synimet e saj strategjike.

Prej vitit 2021 ka filluar së zbatuari Plani Strategjik i ARRU-së 2021-2023, në të cilin janë përcaktuar 6 (gjashtë) Synime Strategjike, të cilat burojnë nga mandati dhe përgjegjësitë ligjore që i ka ARRU. Përmes këtyre Synimeve Strategjike, ARRU synon të avancojë më tutje cilësinë e shërbimeve të sektorit të ujit në përgjithësi. Synimet Strategjike të definuar në Planin Strategjik 2021-2023 janë dhënë në vijim:

1. Avancimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe kornizës rregullatore;
2. Avancimi dhe zbatimi i procesit tarifor për periudhën 2022-2024;
3. Përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotur;
4. Avancimi dhe përmirësimi i standardeve të shërbimeve;
5. Avancimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU; dhe
6. Ngritja e profilit të ARRU në sektorin e ujit.

Raporti i Punës për vitin 2023, përkatësisht kapitulli 5 ku raportohet për aktivitetet e realizuara të ARRU për periudhën raportuese, ndjek logjikën e Synimeve Strategjike të cilat janë zbërthyer pastaj në objektiva përkatëse. Krahas raportimit të statusit të aktiviteteve, janë dhënë përshkrime tekstuale të aktiviteteve të realizuara, krahasuar me aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës për vitin 2023.

### Synimet strategjike 1: Avancimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe kornizës rregullatore

Në kuadër të këtij synimi janë prezantuar aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 për temat vijuese:

- aktet ligjore në të cilat është punuar për ndryshim dhe plotësim,
- vendimet e marra nga ARRU për çështje të rregullimit të shërbimeve dhe çështje tjera relevante,

- shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve dhe procedimin më tej të këtyre ankesave,
- pjesëmarrja në proceset gjyqësore për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve,
- monitorimi i rregullt vjetor i plotësimit të kushteve të licencës nga KRU-të,
- takimi me përfaqësuesit e KRU-ve lidhur me zbatimin e kornizës ligjore.

#### Synimit strategjik 2: Avancimi dhe zbatimi i procesit tarifor për periudhën 2022-2024

ARRU, përmes departamentit të tarifave, gjatë vitit 2023 ka qenë e angazhuar me aktivitetet vijuese:

- monitorimin e zbatimit të procesit tarifor 2022-2024,
- monitorimin dhe raportimi i përmbushjes së caqeve tarifore: faturimi, inkasimi, uji i pafaturuar, investimet kapitale nga burimet vetanake,
- takimi me përfaqësuesit e KRU-ve për çështje të përmbushjes së caqeve tarifore,
- koordinimi me KRU-të në hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve,
- hartimin e raporteve të rregullta periodike lidhur me procesin tarifor dhe përmbushjen e caqeve tarifore.

#### Synimi strategjik 3: Përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotur

Përgjegjësi e ARRU-së është monitorimi dhe raportimi i performancës së KRU-ve. Në kuadër të kësaj përgjegjësie janë planifikuar veprimet vijuese:

- pranimi dhe analizimi i të dhënave për treguesit e performancës së 7 KRU-ve,
- auditimi dhe verifikimi i saktësisë së të dhënave të pranuar nga KRU-të,
- përditësimi i bazës së të dhënave në modulën për ruajtje të dhënave (aplikacioni në MS Access) hartimi i raportit të auditimit / verifikimit të dhënave,
- mbështetja e njësisë së inspektimit në kryerjen e inspektimeve verifikuese dhe tematike sipas kërkesave,
- hartimi dhe publikimi i raportit gjysmëvjetor dhe vjetor të performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë.

#### Synimi strategjik 4: Avancimi dhe përmirësimi i standardeve të shërbimeve

Inspektimi i rregullt i veprimeve të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotur ka për qëllim të verifikojë nëse ofruesit e shërbimeve kryejnë aktivitetet e tyre në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-42 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, në pajtim me rregulloret dhe vendimet e aprovuara nga ARRU. Aktivitetet specifike të organizuara për sa i përket inspektimit të rregullt dhe tematik janë dhenë në vijim:

- inspektimi i të dhënave lidhur me plotësimin e standardeve të shërbimit dhe nivelin e plotësimit të këtyre standardeve të shërbimit,
- përditësimi i të dhënave në modulën e inspektimit,
- hartimi dhe publikimi i raportit për plotësimin e standardeve të shërbimit,
- inspektimi i procedurave të faturimit të konsumatorëve,
- inspektimi i verifikues dhe tematik sipas kërkesave,
- hartimi i raporteve individuale për 7 KRU-të me gjetjet nga inspektimi i keq raportimit të prodhimit të ujit,
- hartimi i raportit nga leximi i ujëmatësve të prodhimit, përfshirë rekomandimet për KRU-të,
- pjesëmarrja në punëtori dhe prezantimi i të dhënave nga inspektimet e kryera.

#### Synimi strategjik 5: Avancimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU

Që ARRU të mund të operojë dhe të ushtrojë përgjegjësitë e saj ligjore, është esenciale që ARRU të sigurojë burimin financiar. ARRU siguron të hyrat nga mbledhja e taksave vjetore të licencimit (TVL) prej KRU-ve.

### Synimi strategjik 6: Ngritja e profilit të ARRU në sektorin e ujit

ARRU gjatë vitit 2023 ka vazhduar bashkëpunimin dhe komunikimin konstruktiv me të gjitha institucionet dhe palët e interesit në Kosovë me qëllim të diskutimit të çështjeve me interes të dyanshëm. Takime të rregullta janë mbajtur me akterët vijues:

- Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti,
- përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë - Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike,
- përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHPK) – përfshirë Qendrat Regjionale të Shëndetit Publik (QRSHP),
- përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI) - Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore;
- përfaqësuesit e Kompanive Regjionale të Ujësjellësve (KRU-të) dhe Bordet e Drejtorëve të KRU-ve,
- përfaqësuesit e Ministrisë së Financave (MF),
- përfaqësuesit e donatorëve të involvuar në sektorin e ujit në Kosovë.

ARRU gjithashtu ka realizuar takime dhe ka mirëmbajtur komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat dhe rregullatorët e ujit të vendeve të regjionit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut), ka vazhduar bashkëpunimin me Rregullatorët Evropianë për Ujë - WAREG (European Water Regulators), DANUBIS (Danube Utility Benchmarking and Information Sharing) që është platformë komunikimi dhe shkëmbimi e njohurive dhe të dhënave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Evropën Juglindore, Lindore dhe Qendrore.

Në aspektin e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, për ARRU është me rëndësi që stafi të jetë i përgatitur për sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet. Është me rëndësi që ARRU si institucion të jetë atraktiv për ekspertët, që të investohet në ngritjen e kapaciteteve të personelit në fushën e rregullativës ujore. Duke qenë se në Kosovë impiantet e para për përpunimin e ujërave të ndotur janë futur në operim tashmë, sfidë për ARRU-në do të jetë caktimi i tarifave “të drejta” për ujërat e ndotur dhe përpunimin e tyre.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është themeluar me Ligjin nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Ky ligji e përcakton kornizën për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura në Kosovë, si dhe përcakton përgjegjësitë dhe autorizimet e ARRU, si rregullator i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij ligji ARRU ka nxjerrë aktet normative sekondare, në bazë të cilave është rregulluar veprimtaria dhe janë specifikuar detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e të gjitha palëve (ARRU, ofruesve të shërbimeve, konsumatorëve, etj.).

Baza ligjore dhe rregullative sipas së cilës funksionon ARRU është dhënë në vijim:

- Ligji Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të Ujit dhe Ligji Nr. 06/l-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

ARRU, ka kompletuar më tej përgjegjësit, funksionet dhe procedurat e punës, përmes legjislacionit dytësor të përmbledhura si në vijim:

- Rregullore Nr. 04/2016 për Inspektimin e Përbushjes së Obligimeve Rregullatore nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr. 09/2019 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve,
- Rregullore Nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr. 11/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 03/2016, rregullores nr. 04/2016, rregullores nr. 05/2016, rregullores nr. 06/2016 dhe rregullores nr. 07/2016,
- Rregullore Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr. 13/2021 për Kartën e Konsumatorit dhe Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit,

### 2.1 SFIDAT LIGJORE ME TË CILAT BALLAFAQOHET ARRU

Ligji bazë sipas të cilit ARRU organizon funksionimin dhe aktivitetet e veta është Ligji Nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe rregulloret përkatëse përmes të cilave rregullohet sektori në tërësi.

Gjatë periudhës së zbatimit të Ligjit për Shërbimeve të Ujit, ARRU ka identifikuar zbrastëti të cilat mund të vlerësohen si sfida për sektorin. Disa nga çështjet e identifikuara janë: pronësia pajisjeve matëse të ujit dhe definimi i specifikacioneve të pajisjeve për matje të ujit, aspektet teknike të instalimit të infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit, faturimi dhe arkëtimi për institucionet fetare, faturimi dhe arkëtimi për ujin e shpenzuar në hidrant, fontanat publike, pagesa e faturave të ujit për konsumatorët me gjendje të vështirësuar ekonomike (rastet sociale), etj. Me ligjin ekzistues të gjitha këto raste janë të lira nga pagesa për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotur, që paraqet ngarkesë tejet të madhe për ofruesit e shërbimeve.

Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në fillim të vitit 2022 ka kërkuar nga ARRU që të hartojë një draft të Ligjit të ri për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

ARRU ka dorëzuar një draft të këtij Ligji tek Komisioni Parlamentar në Maj 2022 dhe ka qenë në takim me anëtarët e komisionit për të arsyetuar ndryshimet e propozuara. Që nga atëherë Komisioni Parlamentar nuk ka bërë asnjë veprim për të proceduar tutje këtë draft ligj.

## 3. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I ARRU

### 3.1 MISIONI DHE VIZIONI I ARRU-SË

ARRU, si autoriteti i pavarur rregullator për shërbimet e ujit, ka përgjegjësi të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efiçente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë. ARRU ka të definuar misionin e saj si në vijim:

Definimi i misionit:

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorët në tërë Kosovën, duke pasur parasysh mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit”.

### 3.2 VIZIONI

Bazuar në kornizën ligjore, ARRU përveç rregullimit të shërbimeve të ujit, ka për obligim të monitorojë që ato shërbime të ofrohen sipas standardeve. Në këtë kuptim vizioni i ARRU është definuar si:

Definimi i vizionit:

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë”.

### 3.3 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka për detyrë rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Përgjegjësitë kryesore të ARRU janë përshkruar si në vijim:

- (i) Licencojë ofruesit e shërbimeve dhe të mbikëqyrë zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit në mënyrë që të mbrojnë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë që tregu të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe brenda kuadrit ligjor;
- (ii) Përcaktojë tarifat e ofruesit të shërbimeve të ujit të pijshëm, ujërave të ndotur dhe ujit me shumicë, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- (iii) Vendos standardet e shërbimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve të ujit;
- (iv) Monitorojë performancën e KRU, duke i nxitur dhe inkurajuar për të ngritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë operative dhe financiare;
- (v) Zgjidhë ankesat e konsumatorëve, për të cilat konsumatori pretendon se ofruesi i shërbimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi;
- (vi) Inspektojë përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;
- (vii) Hartojë dhe miratojë rregullore dhe vendime rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr. 05/L-042 dhe Ligjit Nr. 06/I -088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/I-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

## 4. FUSHËVEPRIMI I ARRU

Autoriteti është themeluar në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2004/49 si Zyre Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM). Më vonë, përmes Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është transformuar në autoritet të pavarur me kompetenca dhe përgjegjësi institucionale vetëm mbi sektorin e shërbimeve të ujit.

ARRU është institucion i pavarur me përgjegjësi për rregullimin e shërbimeve të ujit në Kosovë me llogaridhënie të drejtpërdrejtë para Kuvendit të Republikës së Kosovës. ARRU mbikëqyret dhe komunikon me Kuvendin e Kosovës përmes Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.

Rregullimi i shërbimeve të ujit realizohet përmes Licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotur, të cilët operojnë në zonat e tyre përkatëse të shërbimit. ARRU ka licencuar 7 Kompani Regjionale të Ujit (KRU) dhe 1 kompani për furnizim të ujit me shumicë që është NHE Ibër-Lepenci. Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bërë në vitin 2018 në kohëzgjatje prej 8 vitesh, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042 si dhe Rregulloren Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.


Kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve të ujit në Kosovë janë:

- KRU Prishtina Sh. A. ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë.
- KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë dhe Dragash.
- KRU Hidrodrini Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.
- KRU Mitrovica Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtrri. Gjithashtu kjo KRU ofron ujë të trajtuar me shumicë për komunat në pjesën veriore të Kosovës, por duke qenë se këto komuna nuk janë të integruara nën menaxhimin e KRU Mitrovica, këto sisteme të furnizimit me ujë nuk operohen dhe nuk mirëmbahen nga KRU Mitrovica, ndërsa konsumatorët nuk faturohen dhe nuk ka arkëtim për ujë.
- KRU Gjakova Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe në disa fshatra të komunës së Prizrenit.
- KRU Hidromorava Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Gjiilan, Kamenicë, Viti. Komuna e Novobërdës, Parteshit dhe Ranillugut janë pjesërisht të integruara nën strukturat menaxhuese të KRU Hidromorava, ndërsa komuna e Klllokotit nuk është fare e integruar.
- KRU Bifurkacioni Sh.A. ofron shërbimet në komunën: Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit, ndërsa komuna e Shtërpçës nuk është ende e integruar.
- Kompania e vetme e licencuar që ofron shërbime të ujit me shumicë është Ndërmarrja Hidro Ekonomike (NHE) Ibër-Lepenci Sh.A. që furnizon me ujë të papërpunuar KRU Mitrovica Sh.A. dhe KRU Prishtina Sh.A.

ARRU nuk ka licencuar, nuk ka aprovuar tarifa dhe nuk monitoron kompanitë që operojnë në 4 (katër) komunat në veri të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi), në komunën e Shtërpçës dhe në komunën e Klllokotit.

Komuna e Shtërpçës, përkundër vullnetit politik, ende nuk është integruar nën menaxhimin e KRU Bifurkacioni për arsye të problemeve teknike në sistemin e furnizimit me ujë. Njëjtë, edhe komuna e Klllokotit për shkak të problemeve teknike në sistemin e furnizimit me ujë nuk është e integruar. Në figurën 1 është prezantuar zona e shërbimit sipas KRU-ve dhe mbulueshmëria me shërbime.

## Zona e shërbimit të KRU-ve dhe mbulueshmëria me shërbime - Viti 2022



Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit

Figura 1. Zona e shërbimit me ujë të pijshëm dhe kanalizim

## 4.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARRU

Me qëllim të operimit efektiv, ARRU ka aprovuar strukturën organizative të ndarë në 4 (katër) Departamente dhe 1 (një) Njësi për Inspektim, që mbështetë të gjitha departamentet në ekzekutimin e veprimeve inspektuese në teren. Tri Departamentet (Departamenti për çështje ligjore dhe licencim, Departamenti i tarifave, Departamenti për raportim të performancës) dhe Njësia për inspektim realizojnë aktivitete funksionale të ARRU-së, ndërsa Departamenti i administratës dhe financave është i angazhuar në mbarëvajtjen e çështjeve të brendshme administrative, financiare dhe organizim të logjistikës. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 21, përfshirë Drejtoreshën dhe Zëvendës Drejtorin e ARRU-së. Të gjithë të punësuarit kanë profile adekuate profesionale, përgatitje të larta akademike dhe janë kompetent & profesional për punët dhe shërbimet që i kryejnë.

**Departamenti për çështje ligjore dhe licencim** i siguron Autoritetit mbështetjen ligjore. Ky departament gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore të ARRU-së bazohet në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kompetencave të këtij departamenti është edhe menaxhimi i procesit të licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit, përfshirë edhe vlerësimin në baza të rregullta vjetore të përmbushjes së kushteve të licencimit dhe propozon masa për përmirësim. Në kompetencë të këtij departamenti është edhe menaxhimi ankesave të konsumatorëve, si një nga përgjegjësitë shumë të rëndësishme të Autoritetit.

**Departamenti për tarifa** i siguron Autoritetit mbështetjen në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotur dhe shitjes së ujit me shumicë. Ky proces përfshinë caktimin e caqeve të cilat duhet të arrihen nga KRU-të, gjithnjë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe avancimit të sektorit si tërësi. Përmes procesit të përcaktimit të tarifave, departamenti është gjithmonë transparent me të gjitha palët e interesit, siguron gjetjen e balancës midis mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe mirëmbajtjes/ rritjes së qëndrueshmërisë financiare & operative të ofruesve të licencuar të shërbimeve. Ky departament harton, në baza të rregullta, raporte, analiza dhe vlerësime të përmbushjes së caqeve tarifore, si dhe rekomandon masa apo veprime për përmirësim të politikave dhe procesit tarifor – aty ku vlerësohet e nevojshme.

**Departamenti për raportim të performancës** i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve dhe hartimit të raporteve për treguesit kyç të performancës. Ky departament bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues të performancës dhe interpretimin e tyre. Departamenti harton raportet e rregullta gjashtë-mujore dhe vjetore të performancës, përmes së cilave vlerësohet gjendja dhe performanca e KRU-ve. Raportet tjera vjetore me fokus analizimin e kategorive të shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale janë pasqyrë se si po performon dhe si po zhvillohet sektori i ujit.

**Departamenti i administratës dhe financave** i siguron Autoritetit mbështetje administrative dhe logjistike. Ky departament mbështet Autoritetit për funksionim të përditshëm, duke menaxhuar me burimet njerëzore, buxhetin e Autoritetit, realizon aktivitetet tjera ndihmëse sa i përket inicimit të prokurimeve dhe furnizimit të mallrave & shërbimeve si dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit. Departamenti i administratës dhe financave është përgjegjës që në baza të rregullta vjetore të hartojë raportet financiare për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (Thesarin) dhe për Kuvendin e Kosovës. Po ashtu ky departament është përgjegjës që t'i sigurojë Autoritetit vjeljen e taksave vjetore të licencimit nga KRU-të.

**Njësia për Inspektim** i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e inspektimit për përmbushjen e standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve, realizimin e inspektimeve tematike dhe verifikuese për të gjitha standardet e shërbimeve dhe për të gjitha elementet infrastrukture. Përmbushja e

standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës përmbledhet në raportin vjetor që publikohet në web-faqen e ARRU-së.

Departamentet dhe Njësia për inspektim udhëhiqen nga drejtorët e departamentit dhe udhëheqësi/ja e njësisë së inspektimit dhe i përgjigjen në mënyrë direkte Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të ARRU, si persona përgjegjës për të marrë vendimet kyçe të ARRU. Struktura organizative e ARRU është prezantuar në skemën në vijim.




Figura 2. Struktura organizative e ARRU-së

## 4.2 BORDI I DREJTORËVE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-042.Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit - ARRU nuk ka Bord të Drejtorëve, sipas funksionit dhe mandatit ligjor, për tema me rëndësi për ARRU-në vendimet merren nga Drejtori i ARRU-së në këshillim të përhershëm me zëvendës drejtorin dhe menaxhmentin e mesëm.

## 4.3 EKZEKUTIVI I ARRU

Sipas Ligjit Nr. 05/L-042.Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU udhëhiqet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori të cilët kanë përgjegjësi ligjore për administrimin dhe menaxhimin e ARRU-së, menaxhimin e financave si dhe marrjen e vendimeve në kuadër të mandatit dhe funksioneve rregullatore të Autoritetit. Përgjegjësitë specifike të drejtorit janë:

- Administrimin dhe menaxhimin e Autoritetit;
- Organizimin procedurave dhe punësimin e personelit, aprovimin dhe nënshkrimin e rregulloreve, marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve të Autoritetit;
- Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar Autoritetit;
- Menaxhimin e buxhetit të Autoritetit, arkëtimi e taksës së licencimit dhe mënyrën e shpenzimit të financave;
- Përfaqësimin e Autoritetit brenda dhe jashtë vendit;
- Lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me ligjet në fuqi;
- Angazhimin e ekspertëve të jashtëm me qëllim mbështetjen profesionale të Autoritetit;
- Në mungesë të Drejtorit, Autoriteti udhëhiqet nga Zëvendës Drejtori.

Drejtori i Autoritetit siguron që autoriteti të përmbush objektivat e veta në bazë të Planit Strategjik dhe Planit të Performancës ku reflektohen synimet strategjike, objektivat dhe aktivitetet përkatëse për përmbushjen e përgjegjësisë të autoritetit. Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU, përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar.

- Drejtori është zgjedhur në korrik 2021 me mandat pesë vjeçar,
- Zëvendës Drejtori është zgjedhur në nëntor 2021 me mandat pesë vjeçar.

**Menaxhmenti i mesëm** përbëhet nga Drejtorët e departamenteve dhe Udhëheqësi/ja e Njesisë së inspektimit dhe janë përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e departamenteve/ njesisë organizative përkatëse. Ata këshillohen dhe këshillojnë drejtorin lidhur me temat specifike të njësive organizative përkatëse si dhe detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (Nr. 03-OB/2016) dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (Nr. 05-OB/2019). Mandati i Drejtorëve të departamenteve dhe Udhëheqëses së Njesisë janë të përhershme (akt emërimi).

Koordinimi dhe monitorimi i kryerjes së aktiviteteve të planifikuara në ARRU bëhet përmes takimeve javore ose dy-javore të Ekzekutivit me Menaxhmentin e mesëm. Minutat e takimit mbahen dhe ndahen më të gjithë stafin për komente, por edhe për zbatim të punëve dhe aktiviteteve të dakorduara. Veç kësaj, Ekzekutivi organizon takime të rregullta 3 mujore me stafin e secilit departament dhe të njesisë së inspektimit, për të ndarë informatat rreth zhvillimeve në ARRU, por edhe për të dëgjuar rreth punës, sfidave dhe për shqetësimet e secilit të punësuar në ARRU.

#### 4.4 BURIMET NJERËZORE

ARRU ka të punësuar gjithsej 21 zyrtar duke përfshirë në këtë numër edhe Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin. Struktura profesionale e zyrtarëve është adekuate krahasuar me mandatin, fushëveprimin dhe detyrat që i ka autoriteti. Gjatë vitit 2023 ARRU nuk ka pranuar punëtorë të rinjë, të gjitha pozitat e aprovuara sipas organogramit janë të plotësuara.

Në aspektin e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, për ARRU është me rëndësi që stafi të jetë i përgatitur për sfidat e vazhdueshme me të cilat përballlet sektori i shërbimeve të ujit. Është me rëndësi që ARRU si institucion të jetë atraktiv për ekspertët, që të investohet në ngritjen e kapaciteteve të personelit në fushën e rregullativës ujore.

Në këtë kontekst ARRU ka nevojë për ngritje profesionale të kapaciteteve të stafit qoftë përmes konsulencave nga jashtë apo pjesëmarrjes në trajnime në fushën rregullative të sektorit të ujit dhe ujërave të ndotur. Fushat ku ARRU ka nevojë për ngritje profesionale janë:

Tabela 1. Nevojat për trajnime të stafit të ARRU-së

1	Avancimi i procesit tarifor, metodologjisë dhe modulit për përcaktimin e tarifave, në veçanti është e rëndësishme që të avancohet moduli për përcaktimin e tarifave për pjesën e përpunimit të ujërave të ndotur. Marrja e përvojave të mira rregullative për çështjet e sipër përmendura do të ishte shumë e dobishme për avancimin e procesit tarifor.
2	Avancimi modulit për treguesit kyç të performancës, avancimi bazës së të dhënave në Access ose SQL për treguesit e performancës, krijimi i formateve standarde të tabelave, formateve standarde të raporteve për raportim për nevojat e ARRU dhe për raportim tek palët tjera të interesit. Definimi i treguesve kyç të performancës dhe peshës së tyre, përmes së cilëve do të mateshin arritjet e menaxhmentit në përmbushjen e caqave të vëna në urdhëresën tarifore dhe në planin e biznesit.
3	Mbështetje teknike për zhvillimin e mëtejshëm të modulit të inspektimit, procedurave dhe praktikave të inspektimit dhe përmbushjes së standardeve të shërbimit. Në këtë pjesë do duhej të përfshihej përgatitja dhe përshtatja e listave të kontrollit për lloje të ndryshme inspektimi bazuar në praktikat më të mira të agjencive rregullatore.
4	Mbështetje teknike për personelin ARRU për monitorim të KRU-ve, për hartimin e Planit për Menaxhim të Aseteve dhe Planit të Biznesit që do të mbulonte periudhë më të gjatë kohore, min. 5 deri në 10 vite. Këto dy plane do të shërbenin si udhërrëfyes për definimin e prioriteteve për investime kapitale, për ripërtëritjen e infrastrukturës ekzistuese dhe nevojat për infrastrukturë shtesë në sektorin e ujit duke marrë parasysh sfidat e të ardhmes, ndryshimet klimatike dhe sigurinë e resurseve të ujit.
5	Trajnim i avancuar për përdorim të aplikacioneve softuerike të MS Access & SQL dhe për ArcGIS. Këto aplikacione do të lehtësonin punën e analistëve për insertim, procesim dhe prezantim të të dhënave që mblidhen nga KRU-të. Këto aplikacione do të zhvillonin kapacitetet profesionale të stafit të ARRU për inspektim dhe monitorim të performancës së KRU-ve.

#### 4.5 ASETET

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë dhe Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore e bëjnë regjistrimin e asetëve përmes programit E-Pasuria, ndërsa amortizimin e asetëve vlerë fillestare mbi 1,000 Euro e bën departamenti i thesarit.

Në tabelën në vijim është dhënë lista e asetëve sipas kërkesave për raportim financiar. Vlera e përgjithshme e asetëve pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2023 është si në vijim:

Tabela 2. Vlera e asetëve në posedim të ARRU-së

Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000)				
2023*			Vlera neto 2022	Vlera neto 2021
Vlera origjinale	Amortizimi	Vlera neto 2023		
109,196.09	109,196.09	0.00	0.00	0.00

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)			
Klasifikimi i pasurisë	2021	2022	2023
Pajisjet dhe mobilet	17,388.96	13,912.27	8,338.26
Gjithësejt	17,388.96	13,912.27	8,338.26

Neni 19.3.3 Stoqet			
Klasifikimi i pasurisë	2021	2022	2023
Stoqet	9,946.31	7,332.32	6,276.42
Gjithësejt	9,946.31	7,332.32	6,276.42

ARRU aktualisht operon në objekt privat i marrë me qira prej vitit 2017, i cili ndodhet në Prishtinë në Rr. Ali Pashë Tepelena Nr. 01. Objekti ka 16 zyre pune dhe një zyrë më të madhe për takime. Hapësira është mjaftueshme për të gjithë të punësuarit e ARRU-së.

Më kërkesë të pronarit të objektit është kërkuar që objekti të lirohet deri në korrik-gusht të vitit 2024, me arsyetimin se trualli ku është i ndërtuar objekti ekzistues është dhënë për ndërtim të lartë. Kjo e ka vendosur ARRU-në në pozitë të keqe, pasi duhet me urgjencë të gjejë lokacion të ri për zyre. ARRU është në kërkim të një lokacioni të përshtatshëm me kushte të njëjta dhe në kuadër të buxhetit ekzistues.

ARRU ka komunikuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme për të shiquar opsionin e transferimit eventual të ARRU në objektet që janë duke u ndërtuar në Hajvali për Institucionet Qeveritare dhe Agjencitë Rregullatore. Një objekt që është planifikuar për ndërtim për Agjencitë Rregullatore është ende në fazën e përgatitjes së dizajnit, që do të thotë se ky objekt nuk do të finalizohet para 3-5 vjetësh. Nga ana tjetër as Agjencioni i Privatizimit të Kosovës nuk është përgjigjur në kërkesën e ARRU-së për vënie në disponim të një objekti që ka qenë prone e ish Ndërmarrjeve Shoqërore.

Rrjedhimisht, opsion i vetëm që mbetet në disponim për ARRU-në është marrja me qira sërish e një objekti privat.

## 5. AKTIVITETET PËR PERIU DHËN RAPORTUESE

ARRU përmes këtij Raporti Vjetor të Punës prezanton aktivitetet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2023, aktivitete që janë zbatuar konform Planit Strategjik 2021-2023 dhe Planit të Performancës për vitin 2023. Ky raport do të shërbejë për të krahasuar shkallën e aktiviteteve të realizuara në vitin 2023 kundrejt planifikimeve në planin e performancës për vitin përkatës.

### 5.1 AKTIVITETET E REALIZUARA NË VITIN 2023

Aktivitetet e raportuara në këtë Raport Vjetor të Punës janë listur sipas radhitjes së Synimeve Strategjike dhe Objektivave përkatëse të cilët janë paraqitur në Planin e Performancës për vitin 2023. Për të lehtësuar krahasimin dhe matjen e rezultateve të arritura, për secilin aktivitet të propozuar në Planin e Performancës për vitin 2023, është dhënë përshkrimi i nivelit të përmbushjes, përfshirë edhe treguesit e matjes; e në rastin e mos përmbushjes është dhënë sqarim përshkrues për arsyet e mos-përmbushjes.

#### **Synimi Strategjik 1: Institucionalizimi i bashkëpunimit mes akterëve lokal dhe ndërkombëtar**

ARRU duke qenë institucion me rëndësi në sektorin e ujit, ka venë si prioritet intensifikimin e komunikimit transparent me të gjitha palët e interesit në sektorin e ujit në Kosovë: Ministrinë e Ekonomisë (MeE), Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHKP), Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU), Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës (AMK) dhe me aktërët ndërkombëtar që janë të involvuar në mbështetjen e sektorit të ujit në Kosovë: Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), Bankën Botërore, Zyren Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC/SECO), Ambasadën Franceze, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Rregullatorët e Shërbimeve të Ujit në Evropë (WAREG) dhe rregullatorët e ujit në region, në veçanti.

Komunikimi me palët e interesit të sektorit të ujit në Kosovë është fokusuar në shkëmbimin opinionëve lidhur me krijimin e një mekanizmi me efikas që do të ndikonte në përmirësimin e performancës së sektorit të ujit, në përmirësimin e kualitetit të dhënave të raportuara nga KRU-të, në zhvillimin dhe arritjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar të sektorit të ujit në Kosovë.

ARRU ka pasur komunikime dhe dakordim me MeE (si aksionar i KRU-ve) për sa i përket rritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies së menaxhmentit të KRU-ve, nevojës për rritje të përgjegjësisë së KRU-ve ndaj aksionarit, për nevojën e koordinimit ndër-institucional, sidomos kur bëhet fjalë për investime në infrastrukturën e ujërave. Ka pasur bisedime dhe pajtueshmëri për disa çështje, por nuk ka pasur koordinim për sa i përket financimit të projekteve për investime në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotura.

Me MMPHI është arritur të realizohet një takim, por nuk ka pasur rezultate për sa i përket çështjeve me interes të ndërsjellë, si pajisja me leje ujore dhe harmonizimi i emërtimeve të vendburimeve që janë në shfrytëzim nga KRU-të.

Me institucionet donatore dhe kreditore që financojnë projektet infrastrukturore në Kosovë, ARRU ka pasur takime për zbatimin efikas të projekteve që janë në fazën e projektimit apo ekzekutimit dhe për mundësinë e mbështetjes së ARRU-së për zhvillim institucional (rishikim të metodologjisë tarifore, rishikim të listës së treguesve kyç të performancës dhe rishikim të udhëzuesit për monitorim, raportim dhe auditim të treguesve të performancës).

ARRU ka bërë të qartë se bashkëpunimi dhe angazhimi i sigurtë i të gjitha palëve është thelbësor për avancim të sektorit. Mos harmonizimi i qëndrimeve midis palëve të interesit do të ketë për pasojë vazhdimin e performancës së dobët të sektorit, pa perspektivë për përmirësim të ndieshëm në një të ardhme të afërt. Aktivitetet e realizuara janë përmbledhur në tabelën 3.

Tabela 3. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 1

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
<b>Objektiva 1: Bashkëpunimi ndërinstitucional lidhur me integrimin dhe zgjerimin e zonës së shërbimit të KRU-ve</b>		
1	Takim me të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe komunat, sipas zonave të shërbimit, lidhur me ndryshimin e licencave dhe zgjerimin e zonës së shërbimit.	<p><b>Është realizuar pjesërisht.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>ARRU ka realizuar takime me ofruesit e shërbimeve (KRU-të) për të bërë shtytje për integrim të sistemeve nën menaxhim të KRU-ve dhe për ndryshim/ plotësim të licencave të shërbimeve dhe zgjerim të zonës së shërbimit.</li> <li>Takimet me përfaqësuesit e komunave nuk janë realizuar meqë ARRU nuk ka mundësi dhe as përgjegjësi për përmbushje të kërkesave për investim dhe funksionalizim të sistemeve ekzistuese të furnizimit me ujë.</li> </ul> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Takimet me KRU-të (drejtorët e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe kryeshefat ekzekutiv) dhe Ministrinë e Ekonomisë janë realizuar.</li> <li>Si rezultat që mund të përmendet është regjioni i Pejës, përkatësisht komuna e Junikut ku janë marrë nën menaxhim afërsisht 14 km rrjet të ujërave të ndotura, në komunën e Deçanit janë marrë nën menaxhim afërsisht 51 km rrjet të ujërave të ndotura dhe në komunën e Klinës janë marrë nën menaxhim afërsisht 134 km rrjet të ujërave të ndotura.</li> </ul> <p><b>Rekomandim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>ARRU kërkon involvimin më serioz të Komunave dhe Minsitrisë së Ekonomisë për të përshpejtuar procesin e integritit të sistemeve që janë ende funksionale nëpër të gjitha vendbanimet. Mos detyrimi për integrim i këtyre sistemeve (vendbanimeve) do të ketë për pasojë dëmtimin dhe amortizimin e sistemeve të furnizimit me ujë për shkak të operimit dhe mirëmbajtjes jo profesionale nga operatorë të palicencuar / apo nga vet komuniteti.</li> </ul>
2	Pranimi i aplikacioneve të KRU Bifurkacioni për integrimin e njërive operative të shërbimeve të ujit të Hanit të Elezit dhe Shtërpcës.	<p><b>Është realizuar pjesërisht.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemi e furnizimit me ujë në komunën e Hanit të Elezit është funksionalizuar dhe pranuar teknikisht nga KRU Bifurkacioni në dhjetor të vitit 2023; integrimi i sistemit të Hanit të Elezit në KRU Bifurkacioni është realizuar.</li> <li>Sistemi i furnizimit me ujë në komunën e Shtërpcës ende nuk është rehabilituar sipas kërkesës dhe kushteve të vendosura nga KRU Bifurkacioni për marrje nën menaxhim të këtij sistemi.</li> </ul>

		<p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KRU Bifurkacioni ka bërë kërkesë tek MMPHI për lëshim të lejes ujore për burimet e ujit që shfrytëzohen nga Hani i Elezit.</li> <li>- MMPHI ende nuk ka lëshuar vendim për dhënie të lejes ujore për KRU Bifurkacioni.</li> <li>- Sistemi i furnizimit me ujë në Hanin e Elezit nuk mund të përfshihet në licencë të KRU Bifurkacioni, pasi mungon Leja Ujore, si dokument obligativ për futje zyrtare në licencë.</li> </ul> <p><b><u>Rekomandim:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rekomandohet që KRU Bifurkacioni, MMPHI të gjejnë zgjidhje më të shpejtë për çështjen e lëshimit të Lejes Ujore, pasi burimet në fjalë janë duke u shfrytëzuar për vite me radhë.</li> <li>- Rekomandohet që KRU Bifurkacioni, komuna e Shtërpcës dhe Ministria e Ekonomisë të dakordohen dhe të hartojnë një plan investiv për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë të komunës së Shtërpcës.</li> </ul>
3	Pranimi i aplikacioneve të KRU Hidromorava për integrimin e njësisve operative të shërbimeve të ujit të Ranillugut, Kllokotit, Parteshit dhe Novobërdës.	<p><b>Nuk është realizuar.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa sisteme rurale të furnizimit me ujë të komunave Ranillug, Partesh, Novobërdë dhe shumica e sistemeve të furnizimit me ujë në vendbanimet e komunës së Kllokotit janë jo-funksionale. Rehabilitimi paraprak i këtyre sistemeve jo-funksionale është kusht i vendosur nga KRU Hidromorava për t'i marrë nën menaxhim.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ranillugu, Kllokoti, Parteshi dhe Novobërda ende nuk janë të përfshira në licencë të KRU Hidromorava.</li> <li>- KRU Hidromorava mbetet me mbulueshmërinë më të ulët me shërbime të ujit të pijshëm dhe ndër më të ulëta me shërbime të ujërave të ndotur.</li> </ul> <p><b><u>Rekomandim:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rekomandohet që KRU Hidromorava, përfaqësuesit e komunave Ranillug, Partesh, Novobërdë dhe Kllokot dhe Ministria e Ekonomisë të dakordohen dhe të hartojnë një plan investiv për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë në vendbanimet e komunave të sipër përmendura.</li> </ul>
4	Monitorimi i ofruesve të shërbimeve lidhur me përtëritjen e lejeve ujore si dhe me përmbushjen e kushteve të licencës.	<p><b>Është realizuar si proces.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU, konform përgjegjësisë ligjore, monitoron ofruesit e shërbimeve në mënyrë periodike për përtëritjen e lejeve ujore dhe përmbushjen e standardeve të shërbimeve.</li> </ul>

		<p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i monitorimit dhe i përputhshmërisë të kushteve të licencës i finalizuar dhe publikuar në web-faqen e ARRU-së.</li> </ul> <p>Në lidhje me përtëritjen e <b>lejeve ujore</b> ARRU ka ndërmarrë veprimet vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nga inspektimet e kryera gjatë vitit 2022 dhe 2023 ARRU ka identifikuar një numër të konsiderueshëm burimesh në secilin regjion që shfrytëzohen nga KRU-të, por që nuk posedojnë leje ujore.</li> <li>Lista e burimeve të tilla është ndarë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), por nuk ka pasur reagim nga MMPHI. ARRU e ka ngritë këtë çështje edhe në takim me zv. ministrin e kësaj ministrie, sërish nuk ka pasur reagim.</li> <li>ARRU ka kërkuar nga MMPHI harmonizimin e emërtimeve të burimeve dhe përditësimin e të dhënave për të gjitha burimet, nuk pasur reagim.</li> </ul> <p>Në lidhje me përmbushjen e <b>kushteve të licencës</b> janë ndërmarrë verimet vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Janë hartuar shkresa zyrtare informuese dhe paralajmëruese për ofruesit e shërbimeve që nuk plotësojnë standardet e shërbimit.</li> <li>Janë shqiptuar ndëshkime për ofruesit e shërbimeve që nuk rrespektojnë standardet e shërbimit sipas kushteve të licencës.</li> </ul> <p><b><u>Sqarim:</u></b></p> <p>Çështje problematike mbetet pajisja me leje ujore për burimet e vogla, të cilat sipas legjislacionit në fuqi, komunat janë përgjegjëse për të lëshuar leje ujore. Komunat nuk kanë kapacitete dhe përvojë për të lëshuar leje ujore, e në anën tjetër ka një mos-koordinim midis MMPHI/ Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL) dhe komunave për të adresuar këtë çështje që ka mbetur pezull për vite me radhë.</p>
<p><b>Objektiva 2: Bashkëpunimi ndër-institucional me qëllim të ngritjes së qëndrueshmërisë në sektorin e ujit</b></p>		
<p>1</p>	<p>Organizimi i takimeve dhe debateve me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë së sektorit të ujit në Kosovë.</p>	<p><b><u>Është realizuar.</u></b></p> <p>ARRU mbanë takime të rregullta me të gjithë palët e interesit në sektorin e ujit (Komisioni Parlamentar, ME-NjPMNP, MMPHI, IKSHPK, SHUKOS, etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>ARRU ka mbajtur të informuar Komisionin Parlamentar me zhvillimet në sektorin e ujit në takimet e rregullta të mbajtura dhe iu është përgjigjur kërkesave të anëtarëve të komisionit.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU ka pasur takime me MeE / NjPMNP në lidhje me opsionet për rishikimin/ ndryshimin e formatit ekzistues të Bordeve të Drejtorëve të përzgjedhur nëpër KRU, me qëllim rritjen e efijencës dhe llogaridhënies së ofruesve të shërbimeve si dhe ri-organizimit më të mirë të sektorit.</li> <li>• ARRU ka ndarë me MeE / NjPMNP caqet e planifkuara dhe të realizuara nga KRU-të për të ngritur llogaridhënien dhe përgjegjësinë e bordeve dhe menaxherëve të KRU-ve.</li> <li>• Takimet dhe komunikimet me MMPHI/ ARPL kanë qenë pa rezultate, nuk ka asnjë komunikim dhe përgjigje të MMPHI për asnjë çështje të ngritur nga ARRU.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i takimeve/ debateve të mbajtura, shkëmbimeve të e-mailave, ndarje të dhënave.</li> <li>- Minutat e takimeve dhe rekomandimet e draftuara dhe të aprovuara për veprime të përbashkëta.</li> </ul>
2	Mbështetja e proceseve për rritje të efijencës dhe llogaridhënies me qëllim të përmirësimit të performancës së KRU-ve.	<p><b><u>Është realizuar.</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU ka monitoruar dhe informuar me kohë MeE / NjPMNP për nivelin e përmbushjes së caqeve për 6 treguesit e përzgjedhur të performancës me qëllim të monitorimit të efikasitetit të menaxhmentit të KRU-ve dhe bordit të drejtorëve</li> <li>• ARRU ka njoftuar palët e interesit me nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe masat penalizuese të shqiptuara ndaj KRU-ve që kanë dështuar të zbatojnë kornizën e zbatueshme ligjore.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i zyrtarëve të penalizuar për mos-përmbushje të caqeve</li> </ul> <p><b>Rezultatet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bordet e drejtorëve kanë shqiptuar masa penalizuese për menaxherët e disa KRU-ve; të njëjtat masa penalizuese janë ndërmarrë nga menaxhmenti i KRU-ve edhe ndaj zyrtarëve tjerë nëpër KRU.</li> <li>- MeE/ NjPMNP ka ndërmarrë masa ndaj drejtorëve të bordit në disa KRU.</li> </ul>
<b>Objektiva 3: Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar</b>		
1	Organizimi i takimeve me rregullatorët regional (SHQ, MAQ, MiZ)	<p><b><u>Është realizuar.</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU ka organizuar takime të rregullta bilaterale me rregullatorët e regjionit.</li> <li>• ARRU ka marrë pjesë aktive në serinë e punëtorive të organizuara si pjesë e projekteve mbështetëse të WAREG për</li> </ul>

		<p>rregullatorët regional në lidhje me metodologjinë tarifore dhe monitorimin &amp; raportimin e treguesve të performancës.</p> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Implementimi i përbashkët i projektit regional për mbështetje të rregullatorëve të KOS, SHQ, MAQ dhe MiZ nën menaxhimin e WAREG.</li> </ul>
2	<p>Pjesëmarrja në takime, grupe punuese dhe aktivitete të tjera të organizuara nga WAREG.</p>	<p><b><u>Është realizuar.</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU merr pjesë aktive në takimet e rregullta të asamblesë së përgjithshme dhe në forume të organizuara nga WAREG.</li> <li>• ARRU ka organizuar takimin e 28-të të Asamblesë së Përgjithshme të WAREGU-t.</li> <li>• ARRU merr pjesë në takimet e rregullta të grupeve punuese që funksionojnë në kuadër të WAREG për shkëmbim të përvojave dhe praktikave midis shteteve.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimi/ korespondenca e vazhdueshme përmes e-mailave.</li> <li>- Pjesëmarrja e ARRU në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të WAREG në Portugali, Kosovë, Mali i Zi dhe Belgjikë (Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor 2023).</li> <li>- Pjesëmarrja e kryesuesit të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në Forumin e Rregullatorëve Evropian në Bruksel.</li> <li>- Raportimi i treguesve kyç të performancës tek sekretariati i WAREG-ut.</li> </ul>
3	<p>Raportimi i të dhënave në platformën e projektit DANUBIS dhe pjesëmarrja në takime dhe në grupe punuese sipas kërkesave</p>	<p><b><u>Është realizuar.</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU ka marrë pjesë në takimin vjetor të projektit DANUBIS.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja në takime të organizuara nga ekipi i projektit të DANUBIS.</li> <li>- Ndarja e treguesve kyç të performancës me shtetet anëtare përfituese nga platforma DANUBIS.</li> </ul>
4	<p>a) Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe kërkesa për mbështetje financiare për rishikimin e metodologjisë tarifore b) Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e</p>	<p><b><u>Aktiviteti i realizuar.</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU ka organizuar takime me KfW dhe ka paraqitur kërkesë për mbështetje të ARRU-së përmes konsulencës ndërkombëtare për rishikim dhe modifikim të politikave dhe metodologjisë ekzistuese tarifore.</li> <li>• ARRU ka pasur takime me SDC / SECO dhe ka paraqitur kërkesë për mbështetje të ARRU-së përmes konsulencës për rishikim dhe plotësim të udhëzuesit për monitorim dhe raportim të treguesve kyç të performancës.</li> </ul>

	<p>Zyres Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC / SECO) dhe kërkesa për mbështetje financiare për rishikimin dhe plotësimin e udhëzuesit për monitorim dhe raportim të treguesve kyç të performancës</p> <p>c) Organizimi i takimeve me Bankën Botërore për të diskutuar modalitetet e mbështetjes së KRU-ve për hartimin e planeve të menaxhimit të aseteve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ARRU po ashtu ka pasur takime edhe me përfaqësuesit e Bankës Botërore për të ofruar mbështetje për ARRU dhe KRU-të.</li> </ul> <p><b><u>Treguesit e matjes:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KfW ka aprovuar kërkesën e ARRU-së dhe është pajtuar të financojë një konsulent ndërkombëtar për të punuar në rishikimin e metodologjisë dhe politikave tarifore. Konsulenca pritet të fillojë me aktivitete që në TM1 të 2024.</li> <li>- SDC / SECO ka aprovuar kërkesën e ARRU-së dhe është pajtuar të financojë rishikimin e listës së treguesve kyç të performancës dhe të udhëzuesit për monitorim dhe raportim si dhe të rishikojë mënyrën e auditimit të treguesve kyç të performancës. Konsulenca pritet të fillojë në TM2 / TM3 2024.</li> <li>- Modalitetet eventuale të mbështetjes së Bankës Botërore do të vazhdojnë të diskutohen gjatë vitit 2024 si pjesë e projektit që është duke u zbatuar në regjionin e Ballkanit Perëndimor, që përfshinë edhe Kosovën.</li> </ul>
--	---	---

## Synimi Strategjik 2: Avancimi dhe zbatimi i kornizës ligjore

Bazuar në Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU është institucion i pavarur, i autorizuar që të bëjë hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore, ndërsa Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim ka përgjegjësinë të inicojë dhe udhëheq procesin e hartimit dhe shqyrtimit të akteve ligjore dhe nën-ligjore të ARRU-së. Synimi gjithnjë ka qenë krijimi i infrastrukturës ligjore funksionale dhe të qëndrueshme, e zbatueshme në teren, në mënyrë që të kemi avancim dhe rritje të efektivitetit të punës së ofruesve të shërbimit të ujit, mbrojtje adekuata të konsumatorëve, si dhe përafrimin e legjislacionit të ARRU me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në fillim të vitit 2022, ARRU ka hartuar dhe ka dërguar tek komisioni parlamentar një Draft të Ligjit për “Autoritetin Rregullator dhe Rregullimin e Shërbimeve të Ujit”. Me këtë draft ligj të propozuar janë definuar më qartë përgjegjësitë dhe roli i ARRU-së, janë përcaktuar kompetencat dhe funksionet e Autoritetit, janë specifikuar kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e shërbimeve të ujit, rishikimin e politikave tarifore dhe përcaktimin e tarifave të shërbimit, vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen strikte të zbatimit të këtyre standardeve, mbrojtjen e konsumatorëve dhe për monitorim më strikt të performancës së ofruesve të shërbimeve. Po ashtu me këtë draft ligj janë përcaktuar dispozita të qarta për të siguruar transparencë më të madhe në lidhje me performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe të ujit me shumicë, me qëllim që të kemi përmirësim të vazhdueshëm dhe progresiv të kualitetit të shërbimeve.

Fokus tjetër i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licenca, Njesisë së Inspektimit dhe me mbështetje të menaxhmentit, ka qenë monitorimi dhe zbatimi i kushteve të licencës nga ofruesit e shërbimeve. Në këtë kontekst ARRU ka reaguar konform mandatit të vet, kur ka vërejtur që ofruesit e shërbimeve kanë bërë shmangie nga përgjegjësitë e tyre ligjore apo shkelje të këtyre standardeve dhe përmes shkresave zyrtare, duke dërguar paralajmërime dhe janë marrë vendime për shqiptimin e ndëshkimeve financiare për KRU-të.

ARRU ka rifreskuar të dhënat e licencës së shërbimit për ofruesit e shërbimeve që kanë marrë nën menaxhim sistemet e reja të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit. Në këtë kontekst, përparim më i madh dhe që duhet veçuar është regjistruar në regjionin e Pejës, ndërsa në regjionin e Prizrenit, Mitrovicës, Ferizajit dhe Gjilanit ka pasur progres më të vogël.

Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licenca i ka kushtuar vëmendje trajtimit të ankesave të konsumatorëve përmes Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve (KZAK, në përputhje me Rregulloren për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

ARRU gjatë vitit 2023 ka pranuar, ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për 431 ankesa të konsumatorëve nga KZAK – shkalla e dytë (nga gjithësej 438 ankesa të pranuar). Numri i ankesave të konsumatorëve që janë pranuar në ARRU është rritur dukshëm krahasuar me vitin paraprak; nga 322 ankesa në vitin 2022 numri është rritur në 438 apo rritje prej 36%. ARRU me sukses dhe në mënyrë profesionale është përfaqësuar në të gjitha nivelet e procedurave gjyqësore (Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Dytë dhe Gjykata Supreme). Gjatë vitit 2023 janë parashtruar 61 ankesa apo padi në gjykata (palët e pakënaqura me vendimet e KZAK apo të Gjykatës Themelore); prej tyre në 59 raste vendimet kanë qenë në favor të institucionit të ARRU-së.

Rritja e numrit të ankesave dhe vendimet përfundimtare të gjykatave në favor të ARRU dëshmojnë që ARRU është institucion i pa anshëm dhe objektiv në trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Rritja enorme e ankesave tregon për efikasitetin e lartë në punë dhe besueshmërinë e konsumatorëve ndaj ARRU-së. Në tabelën 4 janë përmbledhur aktivitetet e realizuara në vitin 2023.

Tabela 4. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 2

<b>Objektiva 1: Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe krijimi i një mjedisi më të favorshëm rregullator lidhur me veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të ujit</b>		
1	Rishikimi i kornizës ligjore dhe të akteve nënligjore të ARRU	<p><b>Nuk ka pasur rishikim të kornizës ligjore gjatë vitit 2023.</b></p> <p>ARRU përditëson dhe harmonizon në vazhdimësi kornizën e saj ligjore (Rregulloret) me iniciativë të vet ARRU-së dhe sipas kërkesave të ofruesve të shërbimeve apo palëve të interesit.</p> <p>Në vitin 2023 nuk ka pasur rishikim të kornizës ligjore pasi është pritur që të procedohet për diskutim publik drafti i ligjit të ri për shërbimet e ujit dhe tek pastaj është menduar të rishikohen aktet nën-ligjore (rregulloret).</p>
2	Ndryshim/ plotësimi i Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit	<p><b>Është realizuar pjesërisht.</b></p> <p>ARRU ka hartuar draftin e parë të Ligjit për Autoritetin Rregullator dhe për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe e ka dorëzuar tek Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në muajin maj të vitit 2022 dhe ka bërë arsyetimet për ndryshimet që janë propozuar.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drafti i parë i Ligjit, përfshirë memorandumun me arsyetimin për hartim të draft ligjit, është hartuar dhe dërguar tek Komisioni Palramentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.</li> <li>- Lista e akterëve dhe kontakteve për diskutim/komentim të draftit të Ligjit është ndarë me Komisionin Parlamentar.</li> <li>- Takimi me Komisionin Parlamentar për të arsyetuar ndryshimet e propozuara në ligj është mbajtur në Maj 2022.</li> <li>- ARRU ka ri-përsërtur kërkesën tek komisioni parlamentar për procedim të draft ligjit për diskutim me palët e interesit edhe gjatë vitit 2023.</li> </ul> <p><b>Sqarim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni Palramentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ende nuk e ka vendosur për të proceduar draft ligjin për diskutim me palët e interesit.</li> </ul>
3	Mbështetje profesionale në hartimin e akteve normative të KRU-ve dhe vlerësimin e ligjshmërisë së tyre	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka mbështetë ofruesit e shërbimeve në hartimin, vlerësimin dhe interpretimin e ligjshmërisë së akteve normative të brendshme të ofruesve të shërbimeve.</p>

		<p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ARRU ka hartuar rregulloren për Matje të Ujit, Instalimin dhe Leximin e Pajisjeve Matëse të Ujit, dhe të njëjtën e ka dërguar tek KRU-të për konsultim dhe aprovim nga bordet e drejtorëve.</li> <li>- Janë ofruar shërbime profesionale për të gjitha KRU-të lidhur me çështjet e zbatimit të kornizës ligjore, qoftë përmes shkresave zyrtare apo e-maileve, organizim i takimeve bilaterale dhe shumë palëshe apo përmes organizimit të punëtorive.</li> </ul>
4	<p>Monitorimi i progresit të arritur në nënshkrimin e kontratave në mes të konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve, përfshirë edhe kontrata për shërbime midis komunave dhe ofruesve të shërbimeve</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka monitoruar në vazhdimësi progresin e arritur lidhur me nënshkrimin e kontratave të shërbimit midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimit.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i takimeve me KRU-të me qëllim të shtytjes për të arritur progres për nënshkrim të kontratave me konsumatorët dhe nënshkrimin të marrëveshjeve për shërbime me komunat, si kërkesa ligjore.</li> <li>- Pas presionit të ARRU-së, KRU-të kanë bërë progres të mirë të nënshkrimin të kontratave me konsumatorë; vetëm në vitin 2023 KRU-të kanë arritur të nënshkruajnë 42,176 kontrata me konsumatorë (KRU PRN – 11,514; KRU HRJ – 2,120; KRU HDI – 2,905; KRU MIT – 7,477; KRU GJA - 4,449; KRU BIF – 6,464 dhe KRU HMV – 7,247).</li> </ul>
5	<p>Monitorimi i përmbushjes së kushteve të licencës</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka qenë vazhdimisht vigjilente në monitorimin e ofruesve të shërbimeve për të plotësuar kushtet e licencës për shërbimet e ofruara dhe ka reaguar menjëherë ndaj shkeljeve të identifikuara.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dërgimi i rastit të ujësjellësit “Vodovod Ibar” tek përbaruesi privat, lidhur me ofrimin e shërbimeve pa pasur Licencë të Shërbimeve. Rasti është pezulluar pasi ujësjellësi “Vodovod Ibar” nuk është përgjigjur.</li> <li>- Për mos përmbushje të kushteve të licencës – raportim të pasaktë të dhënave për disa tregues të performancës janë dërguar paralajmërime dhe u janë shqiptuar ndëshkime 4 KRU-ve:</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ KRU Hidrodrini: mos instalim i pajisjeve matëse të ujit në vendburime të ujit, raportim i pasaktë i ujit të prodhuar, i humbjeve të ujit.</li> <li>▪ KRU Hidroregjioni Jugor: raportim të prodhimit të ujit pa matje edhe për burimet që kanë pasur ujëmatës, raportim i pasaktë i ujit të prodhuar, i humbjeve të ujit</li> <li>▪ KRU Gjakova: raportim të pasaktë të ujit të faturuar, shkallës së arkëtimit dhe humbjeve të ujit me qëllim të përmirësimit të performancës</li> <li>▪ KRU Hidromorava: raportim i pasaktë i ujit të prodhuar me qëllim të zvëgëlimit të humbjeve.</li> </ul>
<p><b>Objektiva 2: Avancimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve</b></p>		
<p>1</p>	<p>Takime me KRU-të lidhur me ankesat dhe paditë e parashtruara nga konsumatorët.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Menaxhmenti i ARRU, në bashkërendim me Departamentin për Çështje Ligjore dhe Licenca ka realizuar takime me KRU-të dhe ka diskutuar për çështjet e shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve. Nga KRU-të është kërkuar disa herë që vendim marrja për ankesat e KZAK – shkalla e parë të jetë meritore, e bazuar në kornizën ligjore dhe të mos jenë shkak që ankesat referohen pa nevojë tek ARRU për shkak të ngarkesave të mëdha.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KZAK shkalla e dytë gjatë vitit 2023 i ka pranuar 438 ankesa, përfshirë edhe 19 ankesa të bartura nga viti 2022. Për shkak të vëllimit të shtuar të punëve, 26 ankesa janë bartur për shqyrtim në vitin 2024; të gjitha ankesat tjera janë trajtuar brenda afateve ligjore.</li> <li>- Pra, në total janë organizuar 69 takime të KZAK dhe janë shqyrtuar 431 ankesa.</li> <li>- Vendimet e hartuara për të gjitha 431 ankesa i janë dërguar palëve ankimore brenda afateve ligjore.</li> <li>- Minutat e takimeve dhe diskutimet rreth veprimeve ligjore që duhet të respektohen nga KRU-të kundrejt ankesave në rritje të konsumatorëve.</li> </ul>
<p>2</p>	<p>Pjesëmarrja në seancat dëgjimore sipas nevojës të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave (KZA) për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat e konsumatorëve.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ARRU ka organizuar takime dhe seanca dëgjimore për të shqyrtuar ankesat e parashtruara nga konsumatorët. Po ashtu ka organizuar vizita në terren për të konfirmuar gjendjen faktike, në rastet më të komplikuar.</li> </ul>

		<p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Është organizuar 1 seancë dëgjimore për shqyrtim të ankesave me prezencë të KRU-së dhe konsumatorëve.</li> <li>- Veç kësaj, KZAK ka realizuar 7 vizita në teren tek konsumatorët për verifikimin e gjendjes faktike lidhur me ankesat e parashtruara të konsumatorëve.</li> </ul>
3	<p>Monitorimi dhe inspektimi i rregullsisë së punës së KZAK të shkallës së parë, për pranimin, zgjidhjen dhe vendimmarrjen për ankesa të konsumatorëve.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka organizuar takime me KRU-të për të vlerësuar rregullsinë dhe vendim marrjen nga komisionet të shkallës së parë rreth respektimit të procedurave gjatë procesimit të ankesave të konsumatorëve dhe vendim marrjen e drejtë dhe meritore nga KZAK shkalla e parë.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Minutat nga takimet e organizuara dhe komunikimet tjera me e-mail me anëtarët e komisionit të shkallës së parë rreth procesimit dhe vendim marrjes për ankesat e konsumatorëve.</li> <li>- Nga numri i përgjithshëm i ankesave të trajtuara (431 ankesa): 129 ankesa (~30%) janë kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje tek KZAK shkalla e parë, 109 ankesa (25%) janë pranuar tërësisht ose pjesërisht, 134 ankesa (31%) janë refuzuar, 59 ankesa (14%) kanë qenë ankesa që janë përcjellur për veprime të mëtejshme, që nuk janë bërë brenda afatit ligjor, nuk kanë qenë brenda kompetencave të ARRU-së për shqyrtim dhe të tilla që pala ankimore ka pezulluar ankesën.</li> <li>- Numër i lartë i ankesave të kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje (30%) tregon që vendimet e KZAK shkalla e parë, pra vendimet që merren nga KZAK e formuara nga KRU-të, nuk janë meritore dhe vendoset vetëm sa për të kthyer një përgjigje tek konsumatori brenda afatit ligjor. Ky fakt tej ngarkon punën e ARRU-së për shqyrtim të rasteve të cilat janë shumë qartë të përshkruara dhe definuara në kornizën ligjore.</li> <li>- Shpesh vendimet e shkruara nga KZAK shkalla e parë nuk plotësojnë standardet për sa i përket formatit apo përmbajtjes për një akt të tillë, që po ashtu krijon ngarkesë tek KZAK shkalla e dytë (ARRU).</li> </ul>
4	<p>Takime me Ministrinë e Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë (MTIN)</p> <p>- Departamenti për Mbrojtje e Konsumatorëve (Këshilli për Mbrojtje të Konsumatorit).</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU, përmes Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim, ka marrë pjesë në takimet e ftuara nga Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (Këshilli për Mbrojtje të Konsumatorëve).</p>

		<p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja aktive në 4 takime të Këshillit për Mbrojtje të Konsumatorëve.</li> <li>- Kontributi në hartimin e draft ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.</li> </ul>
5	Pjesëmarrje në seancat gjyqësore për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe KRU-ve.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU, përmes Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim, ka marrë pjesë në seancat gjyqësore lidhur me ankesat e konsumatorëve dhe të KRU-ve.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja në 78 seanca gjyqësore të mbajtura në Gjykatën Themelore.</li> <li>- Numri i padive të parashtruara nga konsumatorët dhe ofruesit e shërbimeve ka qenë 40.</li> <li>- Numri i përgjigjeve në padi për Gjykatën Themelore nga ARRU ka qenë 40.</li> <li>- Numri i ankesave të parashtruar nga ARRU në Gjykatën e Apelit ka qenë 4.</li> <li>- Numri i ankesave të parashtruar nga konsumatorët dhe ofruesit e shërbimeve në Gjykatën e Apelit ka qenë 2.</li> <li>- Përgatitja e materialit dhe dokumentacionit si provë materiale për secilin rast të ankesave.</li> </ul>

### Synimi Strategjik 3: Avancimi dhe zbatimi efektiv i procesit tarifor

Gjatë vitit 2023 ARRU, përmes departamentit të tarifave, ka monitoruar zbatimin e procesit tarifor me të gjitha caqet e aprovuara, me theks në realizimin e investimeve kapitale të aprovuara dhe të përfshira në tarifa, përmbushja e caktuar për nivelin e ujit të pafaturuar – si një prej sfidave më të mëdha të sektorit, efikasitetit të stafit, norma e punës, etj. Këta tregues kyç të performancës dhe caqet për këta tregues janë përcaktuar në dakordim edhe me MeE dhe KNMU për të matur performancën e menaxherëve të KRU-ve.

Tarifat për furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbimet e ujërave të ndotura përcaktohen në bazë të volumit të shitur të ujit duke aplikuar metodologjinë “Price Cap” e cila vendosë koston maksimale volumetrike që ofruesi i shërbimeve mund të faturojë konsumatorët për ofrimin e shërbimeve. Departamenti i tarifave ka analizuar përballueshmërinë e tarifave për konsumatorët duke u bazuar në rekomandimet e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut për qasje në shërbimet për ujë të pijshëm dhe ujëra të ndotura.

Një tjetër aktivitet me rendësi për departamentin e tarifave ka qenë mbështetja dhe mbikëqyrja e KRU-ve në hartimin e Planit për Menaxhimin e Aseteve (PMA). ARRU ka pritur që PMA-të e hartuara këtë vit do të ishin të një kualiteti më të lartë; pas analizës dhe rishikimit të këtyre planeve kemi vërejtur që tek të gjitha KRU-të, përveç progresit të arritur rreth digjitalizimit të infrastrukturës, në aspektin e identifikimit të asetëve kritike dhe të harmonizimit me Planin e Biznesit mbetet shumë punë për t’u bërë. ARRU ka kërkuar që të harmonizohet Plani i Biznesit me Planin për Menaxhim të Aseteve dhe të bëhet një listë e

aseteve kritike të cilat duhet të riparohen / zëvendësohen. Ideja ishte që investimet e propozuara për t'u realizuar në Planin e Biznesit duhet të derivojnë nga Plani i Menaxhimit të Aseteve dhe të ketë një hierarki të qartë të zbatimit të projekteve dhe investimeve në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotur duke u bazuar në planifikim afatgjatë; në aplikimin e konceptit të 'mirëmbajtjes preventive' dhe braktisjen e konceptit të 'mirëmbajtjes reaktive'.

Politikat dhe metodologjia tarifore ekzistuese e ARRU-së daton nga viti 2008, një ndërhyrje e vogël është bërë në vitin 2012 dhe që atëherë nuk ka pasur ndonjë rishikim madhor të këtyre politikave. Me qëllim të harmonizimit të politikave tarifore për shërbimet e ujit me zhvillimin ekonomik në Kosovë, nevojës së reflektimit të aspekteve mjedisore në tarifa sipas parimit ndotësi paguan, ARRU ka vlerësuar si shumë të nevojshme një rishikim madhor të metodologjisë tarifore. Ky rishikim do të realizohet me mbështetje nga një konsulent ndërkombëtar që financohet nga Banka Zhvillimore Gjermane (KfW), që do të implementohet gjatë vitit 2024. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 nga departamenti i tarifave janë prezantuar në tabelën 5.

Tabela 5. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 3

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
<b>Objektivi 1: Monitorimi i zbatimit të investimeve kapitale të përfshira në tarifa</b>		
1	Hartimi i përbalueshmërisë së tarifave për shërbimet e ujit.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Hartimi i raportit që analizon përbalueshmërinë e tarifave për shërbimet e ujit.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti i përbalueshmërisë së tarifave për shërbimet e ujit është hartuar.</li> </ul> <p><b>Gjetjet e raportit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezoluta e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut për qasje në shërbimet për ujë të pijshëm dhe ujëra të ndotura të datës 24 mars 2011, rekomandon që shpenzimet për faturën e ujit mos të tejkalojë 5% të vlerës së të ardhurave mesatare mujore familjare.</li> <li>- Në Kosovë fatura për shërbimet e ujit (në nivel sektori) është llogaritur të ketë pjesëmarrje prej 2.32% të ardhurave mesatare mujore.</li> <li>- Tarifa volumetrike për shërbimet e ujit në Kosovë krahasuar me shtetet tjera në Evropë del të jetë gati më e ulëta, vetëm Moldavia ka tarifën volumetrike më të ulët për shërbime të ujit.</li> </ul>
2	Hartimi i raportit të procesit tarifor	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Raporti i procesit tarifor dhe prezantimi i caqeve të cilat janë vendosur është hartuar.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti i procesit tarifor i hartuar dhe i ndarë me palët e interesit.</li> </ul>

<p>3</p>	<p>Monitorimi/ inspektimi i zbatimit të investimeve (projekteve) kapitale të përfshira në tarifa sipas procesit tarifor 2022-2024</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Një komponent përbërëse dhe shumë e rëndësishme e tarifave janë investimet kapitale nga burimet vetanake të financimit. Prandaj, monitorimi dhe zbatimi i këtyre investimeve është tejet i rëndësishëm për ARRU.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i përbushjes së investimeve kapitale të aprovuar me proces tarifor është realizuar tek 7 KRU-të dhe NHE Ibër-Lepenci.</li> <li>- Raportet nga monitorimi i investimeve kapitale janë hartuar.</li> </ul> <p><b>Gjetjet e raportit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjitha KRU-të kanë dështuar të përmbushin vlerën e planifikuar të investimeve kapitale prej burimeve vetjake të financimit të aprovuara për vitin 2023. KRU-të kanë dështuar të përmbushin edhe vlerën e investimeve të planifikuara nga donacionet.</li> <li>- Vonesat, kërkesa për përsëritje dhe anulimet e aktiviteteve të prokurimit kanë ndikuar në mosrealizimin e projekteve.</li> <li>- KRU-të ndërrojnë destinimin e projekteve, propozojnë për zbatim një projekt dhe realizojnë tjetër projekt. Kjo vije si rezultat i mungesës së planifikimeve strategjike afatgjata dhe mos koordinimit me institucionet që investojnë në infrastrukturën e ujit si: komunat, ministritë dhe donatorët.</li> </ul>
<p>4</p>	<p>Monitorimi i implementimit të metodologjisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Të dhënat për humbjet e ujit dhe treguesit tjerë janë analizuar dhe krahasuar me caqet e vendosura për vitin 2023. ARRU ka punuar edhe në rritjen e besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga KRU-të, siç është instalimi i ujëmatësve nëpër pikat e prodhimit / trajtimit të ujit, si parakusht për të pasur të dhëna të sakta për nivelin real të humbjeve të ujit.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Inspektimet në teren (nga njësia e inspektimit) tek 7 KRU-të, përfshirë hartimin e raporteve të inspektimit për të verifikuar instalimin e ujëmatësve në pikat e prodhimit / përpunimit të ujit.</li> <li>- Takimet me menaxhmentin e KRU-ve dhe kryesuesit e bordeve të drejtorëve dhe NjPMNP janë realizuar për t'ua komunikuar mos përmbushjen e caqeve të</li> </ul>

		<p>planifikuara për sa i përket humbjeve të ujit dhe të treguesve të tjerë të performancës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Si rezultat i instalimit të ujëmatësve të prodhimit dhe rritjes së besueshmërisë së të dhënave për shkak të zbatimit të masave ndëshkuese ndaj KRU-ve, uji i pafaturuar është rritur tek të gjitha KRU-të</li> </ul>
<p><b>Objektivi 2: Realizimi i caqeve nga procesi tarifor</b></p>		
1	<p>Vlerësimi i politikave dhe rregullores ekzistuese tarifore; inicimi i konsultave për të shqyrtuar dhe ri-vlerësuar politikat tarifore</p>	<p><b>Është inicuar faza e parë.</b></p> <p>ARRU ka hartuar një dokument për konsultim me palët e interesit në sektorin e ujit për të prezantuar opsionet dhe modalitetet për rishikimin e politikave dhe metodologjisë tarifore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ARRU, me mbështetje të konsulentit ndërkombëtar, gjatë TM4 2023 ka punuar në draftimin e dokumentit konsultues të metodologjisë tarifore.</li> <li>- Dokumenti do të publikohet dhe do të ndahet me palët e interesit në fillim të vitit 2024 (TM1).</li> </ul>
2	<p>Monitorimi i rrjedhjes së afarizmit të KRU-ve për përmbushjen e caqeve të procesit rregullator të tarifave të vitit 2023.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Departamenti i tarifave gjatë vitit 2023 ka përcjellur afarizmin e KRU-ve dhe përmbushjen e caqeve nga procesi tarifor për vitin 2023.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesimi i të dhënave për përmbushjen e caqeve tarifore për 2023 (TM1 ... TM3 2023).</li> <li>- Krahasimi i realizimit të Planeve të Biznesit të KRU-ve me caqet e aprovuara nga procesi tarifor.</li> <li>- Komunikimi dhe organizimi i takimeve me KRU-të rreth shkallës së realizimit të caqeve tarifore.</li> </ul>
<p><b>Objektivi 3: Harmonizimi i planit të biznesit me planet për menaxhim të aseteve</b></p>		
1	<p>Aprovimi i planit të biznesit (PB) dhe plani i menaxhimit të aseteve (PMA) të KRU-ve për vitin 2023.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka mbështetur KRU-të në hartimin e PMA-ve edhe në vitin 2023. PMA-të e hartuara, pas rishikimit, janë aprovuar me kusht, asnjë KRU nuk ka dorëzuar PMA që përmbushë kriteret e vendosura nga ARRU.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- PB për vitin 2023 janë dorëzuar tek MeE (NjPMNP); ARRU ka vërejtur mos-harmonizim të këtyre planeve me projektet e aprovuara me proces tarifor për vitin 2023.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- KRU-të kanë hartuar draftet e para të PMA-së dhe i kanë dorëzuar tek ARRU për rishikim dhe aprovim.</li> <li>- Draftet e PMA-së janë aprovuar me kusht për të gjitha KRU-të për faktin se nuk është shënuar progresi i pritur në digjitalizimin e infrastrukturës së ujit/ujërave të ndotur në GIS, ka mangësi substanciale në përpilimin e listës së asetëve kritike, defektet në rrjetin e ujit dhe kanalizimit nuk pasqyrohen në GIS. Shumica e KRU-ve kanë deficit për të definuar se cilat janë asetet kritike dhe pse janë asetë kritike.</li> </ul>
2	<p>Analiza nëse projektet kapitale të prezantuara në PB janë në harmoni me projektet në PMA.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Në të gjitha takimet me KRU-të është komunikuar mesazhi se PB dhe PMA duhet të jenë të harmonizuara.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ARRU ju ka dërguar shkresa të gjitha KRU-ve dhe ka njoftuar palët e interesit për mos harmonizim të planit të biznesit dhe të planit për menaxhim të asetëve.</li> <li>- NjPMNP njoftohet që PB para se të aprovohen duhet të ketë koordinim edhe me ARRU-në.</li> <li>- Asetet kritike të infrastrukturës së ujit të identifikuar në PMA nuk reflektohen/ shfletohen në listën e projekteve të propozuara për investim në PB të hartuara nga KRU-të.</li> </ul>

#### Synimi Strategjik 4: Përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve

Është në mandatin e ARRU të monitorojë, vlerësojë trendin e zhvillimit dhe të performimit të ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotur, të raportojë tek institucionet relevante dhe te palët tjera të interesit për gjendjen e sektorit dhe sfidat me të cilat ballafaqohet sektori. Në këtë kuptim, ARRU përmes Departamentit për Raportim të Performancës menaxhon mbledhjen e të dhënave financiare, operative dhe atyre të përmbushjes së standardeve të shërbimit nga KRU-të në baza tre-mujore, bën verifikimin (auditimin) e këtyre të dhënave, përpunon të dhënat e mbledhura dhe harton raportet gjysmë vjetore dhe raportet vjetore të performancës së ofruesve të shërbimit. Të dhënat e mbledhura ruhen në databazën e krijuar në MS Access dhe përditësohen me të dhënat tre-mujore që mblidhen nga KRU-të.

Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor të Performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë është raporti me të cilin identifikohet ARRU, por edhe dokument të cilit i referohen të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë. Përmes publikimit të këtij raporti, ARRU informon para së gjithash institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës (Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës) lidhur me trendin e zhvillimit të sektorit të ujit dhe identifikon sfidat kryesore të sektorit që duhet adresuar. Përveç informimit, ky raport ka edhe karakter krahasues dhe garues midis ofruesve të shërbimeve të ujit.

Për verifikimin e saktësisë së të dhënave të raportuara, ARRU organizon vizita të rregullta tek KRU-të për të kontrolluar fletë-pas-flete të gjitha të dhënat e raportuara dhe krahasimin e tyre me të dhënat nga sistemi i kontabilitetit dhe aplikacionet tjera në prani të përfaqësuesve të secilës KRU. Në fund të procesit të auditimit, ARRU harton raportet e auditimit që ndahen me KRU-të. Auditimi i të dhënave bazohet në udhëzuesin e Kontabilitetit Rregullator.

Departamenti i Raportimit të Performancës ka mbështetur Departamentin për Çështje Ligjore dhe Licencim për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, ka mbështetur Njësinë e Inspektimit në realizimin e inspektimit të ujëmatësve të prodhimit dhe në aktivitete të tjera të organizuara në teren dhe ka mbështetur Departamentin e Tarifave përgjatë procesit të rishikimit të Planit të Menaxhimit të Aseteve (PMA). Në tabelën 6 janë përmbledhur aktivitetet gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 4.

Tabela 6. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 4

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
<b>Objektivi 1: Monitorimi i performancës të ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë</b>		
1	Auditimi i të dhënave për treguesit kyç të performancës për vitin 2022.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Auditimi dhe verifikimi i saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara është proces i rregullt vjetor që organizohet tek secila prej 7 KRU-ve dhe NHE Ibër-Lepenci.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkesat për të dhëna dhe njoftimet për vizitat inspektuese / audituese janë dërguar tek secila KRU dhe NHE Ibër-Lepenci.</li> <li>- Fletat e kontrollit me të dhënat e planifikuara (aprovuara me proces tarifor), të realizuara dhe të raportuara janë krahasuar me të dhënat e gjetura në databazën e KRU-ve gjatë vizitës tek secila KRU.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Inspektimi dhe verifikimi i praktikave për menaxhim të dhënave sipas udhëzuesit për monitorim dhe raportim.</li> <li>- Hartimi i raportit të auditimit për secilën KRU dhe NHE Ibër-Lepenci, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet.</li> </ul>
2	Publikimi i raportit vjetor të performancës për KRU-të dhe për NHE Ibër-Lepenci për vitin 2022.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Hartimi i raportit vjetor të performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë është obligim ligjor i ARRU-së, për të prezantuar para palëve të interesit gjendjen ekzistuese në sektorin e ujit.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesimi i të dhënave të performancës për KRU-të për vitin 2022.</li> <li>- Raporti i Vjetor i Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë për vitin 2022 në formë më të shkurtuar është hartuar, publikuar në webfaqen e ARRU-së dhe është ndarë me palët e interesit.</li> </ul> <p><b>Koment:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti i performancës për ofruesit e shërbimeve për vitin 2022 është publikuar në format më të shkurtuar; në të nuk janë prezantuar disa tregues kyç të performancës, të cilët kanë qenë të raportuar qëllimshëm gabimisht nga KRU-të, për të shtrembëruar të dhënat rreth nivelit të humbjeve të ujit.</li> </ul>
3	Organizimi i punëtorisë dhe tryezave të rrumbullakta me të gjitha palët e interesit në sektorin e ujit për të prezantuar të dhënat e performancës.	<p><b>Nuk është realizuar.</b></p> <p>Duke marrë parasysh se të dhënat e raportuara nga KRU-të për prodhimin e ujit kanë qenë të pa sakta, rrjedhimisht edhe treguesit tjerë që kalkuloohen nga prodhimi i ujit kanë qenë të pa sakta. Për këtë arsye, ARRU kishte vendosur të mos paraqesë në Raportin e Performancës treguesit e zakonshëm të performancës, nuk ka organizuar takim zyrtar për të prezantuar raportin dhe nuk ka bërë rangim të KRU-ve sipas performancës.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ARRU ka inicuar padi / ndëshkime për KRU-të që kanë manipuluar me të dhënat e prodhimit, faturimit, arkëtimit dhe me humbjet e ujit.</li> </ul>
4	Mbledhja e treguesve kryesor të performancës nga KRU për vitin 2023, përmbledhja dhe insertimi i tyre në bazën e të dhënave.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Të dhënat për treguesit kyç të performancës janë raportuar nga KRU-të në baza tre-mujore tek ARRU.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p>

		<ul style="list-style-type: none"><li>- Të dhënat për treguesit kyç të performancës për çdo tremujor janë raportuar nga KRU-të dhe janë insertuar në bazën e të dhënave (në modulën e performancës).</li><li>- Të dhënat janë përmbledhur në raportin gjysmë-vjetor 2023-H1 të performancës.</li></ul> <p><b>Koment:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- ARRU është duke monitoruar dhe verifikuar në mënyrë rigoroze të dhënat e raportuara nga KRU-të në vitin 2023 për të evituar manipulimin e të dhënave.</li></ul>
--	--	--

## Synimi Strategjik 5: Përmirësimi i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimit

Përmbushja e Standardeve të Shërbimit dhe Kushteve të Licencës është një nga aspektet më të rëndësishme në të cilat fokusohet ARRU gjatë inspektimit vjetor që organizohet tek KRU-të. Kjo përgjegjësi ekzekutohet nga Njësia e Inspektimit, mbështetur nga Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim dhe Departamenti i Performancës. Të dhënat e mbledhura gjatë vizitave inspektuese insertohen dhe ruhen në Modulet e Inspektimit dhe përmbledhen në 'Raportin për Nivelin e Shërbimeve të ofruara nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve – Përputhshmëria me Kushtet e Licencës' dhe publikohet në web-faqen e ARRU-së për informim të publikut me kualitetin e shërbimeve të ujit që ofrohen nga kompanitë publike të licencuara.

Duke qenë se Raporti përmban rekomandime, i njëjti përveç që do t'i shërbejë sektorit të ujit për të pasur të dhënat e grumbulluara në një databazë unike, në veçanti i shërben ARRU-së që të përcjellë vit pas viti avancimin e ofruesve të shërbimeve në përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe kushteve tjera të licencës, si dhe do të jetë pikënisje për Njësinë e Inspektimit për të iniciuar inspektime më të detajuara për standardet në të cilat nga ky raport identifikon se ka ngecje.

Përveç inspektimit për përmbushjen e Standardeve të Shërbimit dhe Kushteve të Licencës, që është inspektim i rregullt vjetor, njësia e inspektimit planifikon dhe organizon inspektime verifikuese dhe inspektime tematike, për çështje specifike, që janë me interes për ARRU dhe sektorin në përgjithësi.

**Inspektimet verifikuese** kanë qëllim të konfirmohet niveli i standardeve të shërbimit ku është identifikuar se ka ngecje në përmbushje, për të cilat çështje ka pasur një inspektim paraprak dhe ka pasur rekomandime për përmirësim. Lidhur me këtë çështje, njësia e inspektimit ka organizuar inspektimet verifikuese vijuese:

- Inspektimi i vendburimeve për të verifikuar nëse të gjitha pikat prodhuese të ujit janë të pajisura me ujëmatës funksional. Ky aktivitet kishte pasuar pas vërejtjeve të përsëritura që iu kishin bërë KRU-ve (në vitin 2021 dhe 2022) për instalim të ujëmatësve funksional nëpër të gjitha vendburimet / trajtimin të ujit deri në fund të prillit të vitit 2023.
- Inspektimi i instalimit të ujëmatësve funksional në objektet e kultit dhe analiza e mënyrës së faturimit të kulteve. Lirimi nga pagesa për shërbimet e ujit të kulteve fetare, nuk nënkupton që tek këta konsumatorë nuk duhet lexuar dhe kontrolluar hargjimi. Në anën tjetër mos pagesa e kësaj kategorie të konsumatorëve po shkakton problem të madh për KRU-të.
- Inspektimi i instalimit të ujëmatësve funksional në objektet të cilat janë në pronësi dhe që operohen nga KRU-të dhe analiza e mënyrës së faturimit të këtyre objekteve. Është vërejtur një larmi e mënyrës së faturimit dhe arkëtimit tek këto objekte; disa KRU nuk i faturojnë fare objektet në pronësi të tyre, disa i faturojnë por nuk arkëtojnë, e disa të tjera i faturojnë dhe arkëtojnë. Korniza ligjore specifikon qartë që të gjitha pikat konsumuese duhet të faturohen sipas matjes dhe të aplikohet pagesa për ujin e konsumuar.
- Finalizimi i Planit të Monitorimit të Kualitetit të Ujit sipas kërkesave të UA 10/2021 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor dhe monitorimi i zbatimit të kërkesave të UA për sa i përket numrit dhe lokacionit të mostrave të ujit për analizë. Është arritur dakordimi rreth mënyrës së raportimit të dhënave të kualitetit të ujit nga KRU-të dhe nga IKSHKP / Qendrat Regjionale të Shëndetit Publik; megjithatë raportimi i rregullt i të dhënave nga IKSHKP është sfidë.

Udhëheqësja e njësisë së inspektimit, përveç aktiviteteve të listuara më lartë, ka realizuar edhe këto aktivitete periodike:

- Person kontaktues i ARRU-së për raportim në Ministrinë e Integritit Europian dhe me Rregullatorin Europian të Ujit (WAREG).

- Anëtar i ekipit punues për të vlerësuar projektet që planifikohen të investohen nga donatorët në sektorin e ujit në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur aktivitetet e realizuar në vitin 2023 nga Njësia e Inspektimit.

Tabela 7. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 5

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
<b>Objektivi 1: Inspektimi i zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar të ARRU-së</b>		
1	Inspektimi i pikave kryesore të trajtimit të ujit në zonën e shërbimit të KRU-ve, përfshirë mbledhjen e të dhënave të infrastrukturës tjetër.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat e rregullta inspektuese për verifikimin e gjendjes së impianteve të trajtimit të ujit, instalimit të ujëmatësve në vendburime dhe infrastrukturës tjetër të furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotur.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Paralajmërimet për vizita dhe vizitat tek 7 KRU-të janë realizuar në TM1 2023.</li> <li>- Modulet për raportim të dhënave plotësohen dhe rifreskohen/ përditësohen me të dhënat e fundit për të gjitha elementet e infrastrukturës së ujit dhe ujërave të ndotur.</li> <li>- Hartimi i Raportit me gjetjet nga inspektimi dhe ndarja e tyre me KRU-të.</li> </ul>
2	Hulumtimi dhe inspektimi i rregullshmërisë së leximit të ujëmatësve dhe faturimit volumetrik mujor të konsumatorëve në teren.	<p><b>Nuk është realizuar.</b></p> <p>Me rekomandim të zyrtarit për paralajmërim të konfliktit të interesit, perkatësisht shkeljes së ligjit për mbrojtje të dhënave personale, aktiviteti i planifikuar për inspektim të ujëmatësve të konsumatorëve në teren është anuluar.</p>
3	Inspektimet verifikuese; verifikimi i plotësisë së rekomandimeve nga inspektimet paraprake dhe hartimi i raporteve.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat inspektuese verifikuese për plotësimin e standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës dhe zbatimit të rekomandimeve nga vizitat paraprake janë realizuar tek 7 KRU-të.</p>
	a) Inspektimi i instalimit të ujëmatësve dhe mënyrës së faturimit të objekteve të kulture fetare.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat inspektuese në të gjitha KRU-të për të mbledhë të dhënat nga baza e konsumatorëve për të inspektuar instalimin e ujëmatësve, sipas kërkesave të rregullores për instalim të pajisjeve matëse dhe faturim.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e konsumatorëve të kësaj kategorie është nxjerrë / filtruar nga baza e të dhënave të konsumatorëve.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza e ngarkesës (faturimit) volumetrike mujore të këtyre konsumatorëve.</li> <li>- Vizitë verifikuese për manastirin e Graçanicës, për të verifikuar që objektet administrative dhe tokat e mbjella me hardhi rrushi, që janë në pronësi të manastirit, kanë ujëmatës dhe faturohen me matje.</li> <li>- Raporti i gjetjeve është hartuar dhe ndarë me KRU-të për veprime të menjëhershme.</li> </ul>
	<p>b) Inspektimi i instalimit të ujëmatësve në pikat e prodhimit / trajtimit të ujit.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat inspektuese tek disa vendburime të përzgjedhura / pika të trajtimit të ujit për të inspektuar instalimin e ujëmatësve funksional, përfshirë inspektimin e mirëmbajtjes, ruajtjes dhe arkivimit të dhënave të leximit të ujit të prodhuar, sipas kërkesave ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vizitat në teren tek vendburimet e përzgjedhura është realizuar.</li> <li>- Raporti i gjetjeve, përfshirë rekomandimet nga inspektimi, është hartuar dhe ndarë me KRU-të për veprime të menjëhershme.</li> <li>- Rekomandimi i veprimeve ligjore ndaj KRU-ve që nuk kanë respektuar afatin e dhenë nga ARRU për instalim të ujëmatësve.</li> </ul>
	<p>c) Inspektimi i instalimit të ujëmatësve, mënyrës së faturimit dhe arkëtimit të objekteve që janë në pronësi të KRU-ve.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat inspektuese në të gjitha KRU-të për të mbledhë të dhënat nga baza e konsumatorëve për objektet që janë në pronësi të KRU-ve, sipas kërkesave ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vizitat inspektuese tek KRU-të për të mbledhur të dhënat e faturimit të objekteve që janë në pronësi të KRU-ve.</li> <li>- Analiza e të dhënave dhe hartimi i raporteve të inspektimit me të gjeturat dhe rekomandimet përkatëse.</li> <li>- Ndërmarrja e veprimeve ligjore ndaj KRU-ve që aplikojnë veprime në kundërshti me kornizën ligjore.</li> </ul>
	<p>d) Konfirmimi i hartimit të Planit për Monitorim të Kualitetit të Ujit</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Pjesëmarrja në takimet e organizuara nga IKSHKP për të konfirmuar finalizimin dhe aprovimin e planeve të monitorimit të kualitetit të ujit të hartuara nga KRU-të sipas kërkesave të UA 10/2021.</p>

		<p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja aktive në takimet për finalizimin e planeve për monitorim të kualitetit të ujit.</li> <li>- Planet e monitorimit të kualitetit të ujit të finalizuara dhe të aprovuara nga IKSHP.</li> <li>- Dakordimi për modalitetet e raportimit të dhënave të kualitetit të ujit tek ARRU, përmes KRU-ve, përmes QRSHP-ve dhe IKSHPK.</li> </ul>
4	<p>Inspektimi i përmbushjes së nivelit të shërbimeve sipas Kushteve të Licencës (Përditësimi i Modullit për inspektimin e standardeve dhe kushteve tjera të licencës).</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Vizitat e rregullta inspektuese për përmbushje të standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës janë realizuar tek 7 KRU-të.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vizitat inspektuese janë realizuar tek 7 KRU-të me qëllim të verifikimit të dhënave për standardet e shërbimit sipas kushteve të licencës, për infrastrukturën tjetër të furnizimit me ujë dhe për shërbimet e ujërave të ndotur.</li> <li>- Modulet me të dhënat për infrastrukturën e shërbimeve të ujit janë ri-freskuar me të dhënat më të fundit që korrespondon me datën e inspektimit.</li> </ul>
5	<p>Përgatitja/ hartimi i Raportit të Plotësimit të Standardeve të Shërbimit dhe përputhshmërisë me kushtet e licencës.</p>	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Sipas kornizës ligjore Njësia e Inspektimit është e obliguar të hartojë raportin për përmbushjen e standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti për Nivelin e Shërbimeve të Ujit të Ofruara nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve – Përputhshmëria me Kushtet e Licencës është hartuar dhe publikuar në web-faqen e ARRU-së për informim të palëve të interesit dhe publikut.</li> </ul>

### Synimi Strategjik 6: Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU

Përgjegjësia e Departamentit të Administratës dhe Financave është të përkrahë dhe mbështesë funksionimin dhe monitorimin e brendshëm të ARRU, përmes menaxhimit të buxhetit dhe financave të autoritetit, menaxhimit të burimet njerëzore dhe aseteve të autoritetit, përfshirë aktivitetet logjistike për mbarëvajtje të punëve dhe aktiviteteve të rregullta të Autoritetit.

Departamenti i administratës dhe financave është përgjegjës që në baza të rregullta vjetore të hartojë raportet financiare për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe për Kuvendin e Kosovës, të përkrahë ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të regjistrimit, menaxhimin e dokumentacionit dhe të dhënave, protokolimin, klasifikimin, arkivimin e dokumenteve, përditësimin e sistemit të informacionit dhe web-faqes së ARRU-së.

Departamenti i administratës dhe financave komunikon në baza të rregullta me KRU-të për vjeljen e taksave vjetore të licencimit (TVL), të cilën KRU-të janë të obliguara të paguajnë për funksionimin e ARRU-së. Mirëmbajtja dhe ofrimi i shërbimeve të teknologjisë informative si: mirëmbajtja hardware-it, software-it dhe mirëmbajtja dhe publikimi i njoftimeve, lajmeve / informatave dhe dokumenteve në web-faqe të ARRU administrohet po ashtu përmes departamentit të administratës dhe financave. Në tabelën 8 janë përmbledhur aktivitetet e realizuara nga departamenti i administratës dhe financave.

Tabela 8. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në kuadër të Synimit Strategjik 6

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
<b>Objektivi 1: Zhvillimi dhe avancimi profesional i stafit</b>		
1	Trajnimi i stafit.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Trajnimi dhe avancimi profesional i stafit, pjesëmarrja në trajnime në fushën e rregullimit të shërbimeve të ujit apo të ngjashme është me shumë rëndësi për zhvillimin e ARRU-së.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja e 3 zyrtarëve prej Departamentit të Tarifave në tre punëtori regjionale (Budvë, Shkup dhe Tiranë) të organizuar nga WAREG lidhur me çështjet e metodologjisë tarifore, komponentëve që përbëjnë tarifat dhe ndarja e përvojave për mënyrën e përcaktimit të tarifave me shtetet anëtare të regjionit.</li> <li>- Pjesëmarrja e 2 zyrtarëve prej Departamentit të Performancës në dy punëtori regjionale (Prishtinë, Tiranë) organizuar nga WAREG lidhur me çështjet monitorimit të performancës dhe tregusit kyç të performancës dhe ndarja e përvojave me shtetet e regjionit.</li> <li>- Pjesëmarrja e 1 zyrtari në trajnimin e organizuar nga IKAP në temën “Shkrimi dhe prezantimi efektiv” dhe “Hartimi dhe përgatitja deklaratave dhe kampanjave informuese”.</li> </ul>
2	Pjesëmarrja në forume dhe konferenca brenda dhe jashtë shtetit.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU merr pjesë aktive në takimet, konferencat dhe forumet që organizohen nga institucionet vendore dhe organizatat e jashtme.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të WAREG (4 takime: Kosovë, Mali i Zi, Hungari, Belgjikë).</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja në forumin e rregullatorëve të shteteve brenda pellgut të Danubit – pjesë e projektit DANUBIS (1 takim - Austri).</li> <li>- Pjesëmarrja në forumin e rregullatorëve të shërbimeve të ujit të organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA) me pjesëmarrje të rregullatorëve të ujit nga e gjithë bota.</li> </ul>
<b>Objektivi 2: Planifikimi dhe administrimi operativ dhe financiar</b>		
1	Mbyllja e vitit fiskal 2022 dhe hapja e vitit fiskal 2023.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Mbyllja e vitit fiskal 2022 dhe hapja e vitit fiskal 2023 është bërë me sukses dhe sipas afateve ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasqyrat financiare për vitin 2022 janë audituar dhe dorëzuar tek Ministria e Financave.</li> <li>- Raporti i auditorit nuk ka asnjë gjetje dhe asnjë rekomandim për vitin fiskal 2022.</li> <li>- Shpenzimet për vitin fiskal 2023 janë inicuar konform procedurave dhe planifikimeve.</li> </ul>
2	Monitorimi dhe menaxhimi i buxhetit të ARRU dhe raportimi i rregullt financiar.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU ka menaxhuar me buxhetin e saj (shpenzimet dhe arkëtimet) në mënyrë shumë të suksesshme.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i shpenzimeve është realizuar në nivelin 88.7% krahasuar me planifikimet.</li> </ul>
3	Hartimi i Raporteve Financiare për Ministrinë e Financave (Thesarin) dhe për Kuvendin e Kosovës.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU është e përpikët në hartimin dhe dorëzimin e të gjitha raporteve tek institucionet mbikëqyrëse (Parlamenti i Kosovës dhe Ministria e Financave - Thesari) konform kërkesave ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti financiar është hartuar dhe është dorëzuar me kohë tek institucionet relevante (Parlamenti i Kosovës dhe tek Minsitria e Financave).</li> </ul>
4	Realizimi i prokurimeve sipas planit.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Prokurimet që kanë qenë të planifikuara në buxhetin për vitin 2023 janë realizuar duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjitha mallrat dhe shërbimet e blera janë pranuar nga ARRU gjatë vitit 2023.</li> </ul>

5	Regjistrimi dhe mirëmbajtja e aseteve.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>Databaza e aseteve të ARRU-së mirëmbahet duke respektuar procedurat dhe kërkesat ligjore.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrimi i aseteve është kryer në fund të vitit 2023 konform kërkesave ligjore.</li> <li>- Lista e aseteve është regjistruar në programin e-Pasuria.</li> <li>- Raporti i vlerësimit të pasurisë dhe raporti për tjetërsim të pasurisë jo financiare është hartuar dhe aprovuar.</li> </ul>
6	Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU-së, vjelja e taksave me kohë nga KRU-të.	<p><b>Është realizuar.</b></p> <p>ARRU iu faturon KRU-ve taksën vjetore të licencimit (TVL), e cila transferohet në buxhetin e konsoliduar të Kosovës bazuar në kornizën ligjore të aplikueshme.</p> <p><b>Treguesit e matjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dërgesa e kësteve mujore tek KRU-të për pagesë të taksës vjetore të licencimit.</li> <li>- Vjelja e taksës vjetore të licencimit nga KRU-të është realizuar në nivelin 99.14%. Gjatë vitit 2023 është arritur të mblidhen edhe borxhet e vjetra nga ofruesit e shërbimeve (referoju raportit financiar).</li> <li>- Monitorimi i pagesës së faturave nga KRU-të, në rast mos pagese, dërgimi i njoftimeve dhe paralajmërimeve për mos pagesë të TVL.</li> <li>- Hapja e rasteve gjyqësore dhe përmbarimore ndaj KRU-ve që dështojnë të paguajnë TVL.</li> </ul>

## 6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET

ARRU gjatë vitit 2023 është angazhuar me kapacitetet e saj njerëzore & profesionale me të gjitha palët e interesit për avancimin e sektorit të ujit. Angazhimi i ARRU-së ka qenë i fokusuar në promovimin e një klime të bashkëpunimit transparent ndër-institucional, ku secili institucion do të jepte kontributin në fushën e vet të përgjegjësisë.

Përkundër arritjeve dhe avancimit të sektorit të ujit nga viti në vit, gjendja nuk është e kënaqshme; mungojnë plane dhe strategji të koordinuara (aftashkurtëra, afatmesme dhe afatgjata) ku do të listoheshin prioritetet e zhvillimit të sektorit dhe do të definoreshin përgjegjësitë e secilit institucion. Nga këndvështrimi i ARRU-së, sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohet sektori i ujit, e që kanë pasur ndikim edhe te puna dhe funksionimi i ARRU-së janë listuar si në vijim:

### **Procedimi më tej i draft ligjit për “Autoritetin Rregullator dhe Rregullimin e Shërbimeve të Ujit” i hartuar nga ARRU**

- Hartimi i këtij ligji është paraparë në Planin e Veprimit 2023-2025 të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027. ARRU me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka hartuar dhe dorëzuar draftin e propozuar të ligjit të ri-formuluar në maj të vitit 2022 dhe që nga atëherë Komisioni nuk ka proceduar tutje. Përmes këtij draft ligji, ARRU beson se do të definoreshin më qartë roli dhe përgjegjësitë e ARRU-së, do të definoreshin përgjegjësitë dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve, do të ri-definoreshin politikat taifore, në veçanti për sa i përket reflektivitetit të tarifave për shërbimet e ujërave të ndotur, vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre standardeve dhe mbrojtjen e konsumatorit.
- Gjithashtu janë përcaktuar dispozita të qarta që e rregullojnë përgjegjësinë ofruesve të shërbimeve për raportim objektiv dhe transparent të performancës së operimit dhe për të siguruar përmirësim progresiv të kualitetit të shërbimeve.
- ARRU rekomandon që Komisioni Parlamentar të procedojë tutje për procedura të diskutimit dhe debateve publike të propozim draft ligjit për “Autoritetin Rregullator dhe Rregullimin e Shërbimeve të Ujit”.

### **Rritja e numri të stafit të ARRU-së:**

Sfidë me ndikim të madh në operimin efektiv të ARRU-së është vazhdimi i aktiviteteve me numër kaq të vogël të stafit.

- Zgjerimi i vazhdueshëm i zonës së shërbimit të KRU-ve, vetdijësimi i konsumatorëve për t’u ankuar për shërbimet që nuk ofrohen sipas standardeve të aprovuara, futja në përdorim i impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura në Kosovë ka ndikuar që të shtohet vëllimi i punës së ARRU. Për këtë arsye në ARRU është e domosdoshme të punësohen në një afat sa më të shkurtër kohor **3 të punësuar të rinjë**: 1 i/e punësuar në Departamentin Ligjor, 1 i/e punësuar në Njësinë e Inspektimit dhe 1 i/e punësuar në Departamentin e Tarifave.
- **Arsyetim:**
  - Rritja e madhe e numrit të ankesave që arrijnë tek ARRU në vitet të fundit, qoftë ankesat apo paditë e konsumatorëve kundrejt KRU-ve dhe anasjelltas, ka ndikuar në ngarkesën e ARRU-së për shqyrtim të ankesave dhe pjesëmarrje në seanca gjyqësore. Për të përballuar këtë fluks gjithnjë e në rritje të ankesave është i nevojshëm punësimi i 1 (një) juristi për të trajtuar ankesat e konsumatorëve.
  - Edhe njësia e inspektimit ka qenë tejte e zënë me inspektimet e rregullta në teren (inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit, inspektimet tematike dhe inspektimet verifikuese). Për të shtuar prezencën në teren me qëllim inspektimin e aspekteve teknike dhe operative të ofruesve

të shërbimeve në gjithë zonën e shërbimit ka shtruar domosdonë për 1 (një) inxhinier për të mbuluar aktivitetet e inspektimit në teren.

- Departamenti i tarifave deri në vitin 2020 ishte kryesisht i angazhuar me përcaktimin e tarifave vetëm për shërbimet e ujit të pijshëm dhe për kanalizim. Që nga 2021 numër gjithnjë e më i madh i impianteve të përpunimit të ujërave të ndotur (IPUN) po futen në operim, për të cilat duhet të aplikohet një model krejt i ri dhe më kompleks i përcaktimit të tarifave. Përcaktimi i tarifave për ujëra të ndotur kërkon hulumtime dhe analiza më të detajuara për kostot që do të rrjedhin nga operimi i këtyre impianteve, po edhe verifikime në teren. Rrjedhimisht edhe departamenti i tarifave ka nevojë për 1 (një) të punësuar qoftë inxhinier ose ekonomist që do të merret me të gjitha aspektet për përcaktimin e tarifave për IPUN.

#### **Bashkëpunimi ndër institucional dhe shkëmbimi i informatave:**

- Komunikimi jo-adekuat midis institucioneve për sa i përket çështjeve të definimit të kahjeve zhvillimore të sektorit dhe përcaktimit të prioriteteve për investime në infrastrukturë të ujit dhe ujërave të zeza, nga këndvështrimi i ARRU vlerësohet të jetë një prej problemeve madhore të sektorit. Investimet në infrastrukturë të ujit dhe ujërave të ndotura të cilat financohen nga komunat apo Qeveria shpesh nuk reflektojnë prioritetet e prezantuara nga KRU-të në planet e tyre të biznesit dhe planet e menaxhimit të aseteve. Problematike është edhe shpërndarja e investimeve nëpër regjione.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi me palët e interesit për sa i përket integritet të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë nën menaxhimin e KRU-ve. Qëllimi është që sistemet e tilla të menaxhohen nga KRU-të dhe mos të përkeqësohet më tej gjendja e tyre në mungesë të operimit dhe mirëmbajtjes adekuate. Pë disa vite me radhë ka ngecje të zgjerimit të zonës së shërbimit.

#### **Hartimi i planeve strategjike të KRU-ve:**

Infrastruktura e ujit dhe ujërave të ndotura luan një rol kyç në sigurimin e qasjes në ujë të pijshëm të pastër të sigurt dhe për ofrimin e shërbimeve të higjienës. Infrastruktura ujore është po ashtu gur themel i zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të shoqërisë dhe që merr parasysh sfidat globale gjithnjë e në rritje. Për këtë arsye kërkohet që ofruesit e shërbimeve të kenë të hartuar plane afat mesme dhe afatgjata që adresojnë sfidat dhe minimizojnë pasojat eventuale.

Sipas kornizës ligjore dhe rregullative, KRU-të janë të obliguara të hartojnë dhe zbatojnë Planin e Biznesit (PB), Planin e Menaxhimit të Aseteve (PMA), Planin Afatgjatë të Investimeve (PAI), Planin për Menaxhimin e Thatësisë (PMTh) dhe Planin për Furnizim me Ujë në Situata Emergjente (PFUSE), Planin për Monitorimin e Kualitetit të Ujit (PMKU).

Për vitin 2023 ARRU ka kërkuar dhe kishte ofruar mbështetje për KRU-të në hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve. Drafti i parë i këtij plani është hartuar nga KRU-të dhe është dorëzuar tek ARRU për aprovim. Pas rishikimit të drafteve të para të këtij plani është vlerësuar se dokumentet e dorëzuara nuk i plotësojnë kërkesat e vendosura dhe nuk është fare i harmonizuar me planin e biznesit.

Dokumentet tjera strategjike nuk janë hartuar fare ose janë të një kualiteti të dobët, që reflekton edhe nivelin e profesional të KRU-ve. Nga këndvështrimi i ARRU-së hartimi i planeve për mirëmbajtje të infrastrukturës ekzistuese dhe për rritje / zhvillim të infrastrukturës së re, listimi i prioriteteve është proces që kërkon konsensus dhe dakordim të gjithë palëve të interesit, gjë që është duke munguar.

## 7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit financohet nga Taksat Vjetore të Licencës (TVL) të cilat ofruesit e shërbimeve janë të obliguara të paguajnë për shërbimet ndaj ARRU-së. Taksat vjetore të licencës transferohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

### 7.1 TË HYRAT

Lartësia e taksave vjetore të licencës për vitin 2023 ka qenë 368,661.26 Euro dhe është prezantuar në tabelën 9.

Tabela 9. Të hyrat e ARRU-së nga TVL

Të hyrat nga Taksat Vjetore të Licencimit (TVL)	Të planifikuara (EURO)	Të arkëtuara (EURO)
Të hyrat nga taksa vjetore e licencimit për vitin 2023	401,235.61	397,758.29
Te hyrat nga marveshja KRU Mitrovica 2019		3,083.73
Të hyrat nga marrëveshja me KRU Mitrovica		15,370.24
Te hyrat nga KRU Gjakova për dhjetor 2022 – pagesë me vonesë		3,812.79
Te hyrat nga KRU Mitrovica për gusht-shtator dhe dhjetor 2022 - pagesë me vonesë		9,792.27
Te hyrat nga KRU Mitrovica dy keste të marveshjes 2023		6,528.18
Te hyrat nga ndëshkimi i KRU Hidroregjioni Jugor		8,000.00
<b>Gjithësej</b>	<b>401,235.61</b>	<b>444,345.50</b>

Siç mund të shihet, të hyrat e realizuara të ARRU-së për vitin 2023 janë më të larta se sa ato të planifikuara, për shkak të arkëtimit të borgjeve të vjetra prej KRU Mitrovica dhe ndëshkimit të KRU Hidroregjioni Jugor.

### 7.2 BUXHETI

Buxheti i ARRU-së për vitin 2023 është përmbledhur në tabelën 10. Buxheti i planifikuar nga ARRU është aprovuar nga Ministria e Financave.

Tabela 10. Buxheti i ARRU-së

Buxheti	I popozuar nga ARRU (EURO)	I aprovuar nga MeF (EURO)
Paga dhe mëditje	243,322.00	236,335.00
Mallra dhe shërbime	150,000.00	150,000.00
Shpenzime kapitale	-	-
Shërbime komunale	6,503.00	6,503.00
<b>Gjithësej</b>	<b>399,835.00</b>	<b>392,838.00</b>

### 7.3 SHPENZIMET BUXHETORE

Për realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2023 ARRU ka shpenzuar këto shuma sipas aktiviteteve ekonomike:

Tabela 11. Realizimi i shpenzimeve

Shpenzimet	Shpenzimet (EURO)	Suficiti (EURO)	Përqindja e realizimit
Paga dhe mëditje	236,335.00	0.00	100.0%
Mallra dhe shërbime	109,057.54	40,942.46	72.71%
Shpenzime kapitale	-	-	-
Shërbime komunale	3,226.87	3,276.13	49.63%
<b>Gjithësej</b>	<b>348,619.77</b>	<b>44,185.59</b>	<b>88.75%</b>

Deri në fund të vitit kalendarik 2023 (31.12.2023) ARRU nuk ka mundur të bëjë të gjitha pagesat për mallrat dhe shërbimet dhe për shërbime komunale, për shkak të vonësës së dorëzimit të faturave me kohë nga operatorët. Faturat e papaguara kapin vlerën prej 2,858.08 Euro.

Vlera më e madhe e pashpenzuar tek mallrat dhe shërbimet është aktiviteti i anuluar në vlerë prej 25,000.00 Euro. Ky aktivitet ka pasur të bëjë me inspektimin e rregullshmërisë së leximit të ujëmatësve të konsumatorëve në teren dhe mënyrës së faturimit të konsumatorëve nga KRU-të. Zyrtari për sinjalizim të konfliktit të interesit ka tërhequr vërejtjen se procedimi me aktivitetin e “inspektimit të mënyrës së leximit të ujëmatësve të konsumatorëve në teren” bie ndesh me dispozitat e “ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe si aktivitet nuk është në përgjegjësi të ARRU. Rrjedhimisht, zyrtari sinjalizues kishte rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, të cilin rekomandim menaxhmenti i ARRU-së e ka përfillur.

## **8. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

Deri në hartimin e këtij raporti, ARRU nuk e ka pranuar raportin e auditimit nga kompania që ka kryer auditimin e financave për vitin 2023. Për sa i përket raportit të auditimit për vitin 2022, auditori nuk ka pasur asnjë gjetje dhe asnjë rekomandim.

## SHTOJCA 1: TË DHËNAT E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Në këtë shtojcë do të jepen disa të dhëna rreth performancës së KRU-ve për vitin 2023. Duhet të sqarohet se treguesit e performancës operative dhe financiare ende nuk janë audituar nga ARRU, pasi ky proces fillon në muajin prill, pasi të ketë përfunduar periudha e raportimit të KRU-ve tek institucionet përkatëse.

### SH-1.1: ANKESAT DHE NATYRA E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE

Në tabelën 12 është paraqitur numri i ankesave të pranuar nga konsumatorët për vitin 2021 dhe 2022, ankesat që janë zgjidhur nga Komisioni për Zgjidhje të Ankesave të Konsumatorëve (KZAK) dhe numri i proceseve gjyqësore.

Tabela 12. Numri i ankesave të konsumatorëve

#	Përshkrimi i aktivitetit	2021	2022	2023
1	Numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët	272	322	438
2	Numri i takimeve të mbajtura të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve (KZAK)	130	104	69
3	Gjithësej numri i ankesave të zgjidhura	252	322	431
4	Numri i padive të parashtruara nga konsumatorët në gjykatën themelore dhe në gjykatën e apelit	25	54	46
5	Pjesëmarrja në seanca gjyqësore	27	53	78

Në tabelën 13 është paraqitur numri i ankesave të zgjidhura nga KZAK për vitin 2023 sipas muajve dhe regjioneve, ndërsa në tabelën 14 është paraqitur natyra e ankesave të konsumatorëve.

Tabela 13. Numri i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura sipas regjioneve

Përshkrim	Ankesat e zgjidhura sipas muajve dhe regjionit (viti 2023)												Gjithësej
	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh	
KRU Prishtina	40	16	30	11	27	33	13	25	18	27	30	4	<b>274</b>
KRU Mitrovica	0	0	0	0	1	1	3	2	4	2	0	2	<b>15</b>
KRU Hidrodrini	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	<b>2</b>
KRU Gjakova	1	4	8	4	1	1	9	3	6	3	10	0	<b>50</b>
KRU Hidroregjioni	2	2	3	1	2	2	0	0	3	1	0	0	<b>16</b>
KRU Bifurkacioni	5	5	7	5	11	7	4	3	4	2	2	0	<b>55</b>
KRU Hidromorava	6	1	0	2	0	2	0	1	2	1	1	3	<b>19</b>
<b>Gjithësej</b>	<b>55</b>	<b>28</b>	<b>48</b>	<b>23</b>	<b>42</b>	<b>46</b>	<b>29</b>	<b>34</b>	<b>37</b>	<b>36</b>	<b>44</b>	<b>9</b>	<b>431</b>

Tabela 14. Numri i ankesave të konsumatorëve sipas regjioneve dhe natyrës së ankesave

KRU	Kontestim i faturimit	Faturimi paushall	Mos lexim i rregullt i UM	Kontestim i borgjit	Të tjera	Gjithsej
KRU Prishtina	170	12	9	65	20	276
KRU Mitrovica	7	2	1	6	0	16
KRU Hidrodrini	1	0	0	0	1	2
KRU Gjakova	32	5	0	7	11	55
KRU Hidroregjioni	7	2	1	5	1	16
KRU Bifurkacioni	31	3	0	19	1	54
KRU Hidromorava	12	1	0	6	0	19
Gjithësej	260	25	10	108	35	438

Tabela 15. Shpërndarja e ankesave të pranuar sipas kategorive të konsumatorëve

Ankesat	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë biznes-industri	Konsumatorë institucional	Gjithësej
Numri i ankesave	383	48	7	438

## SH-1.2: TREGUESIT E PERFORMANCËS TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

### Cilësia e ujit të furnizuar nga ofruesit e shërbimeve të ujit

Të dhënat lidhur me kualitetin e ujit janë të raportuara nga KRU-të individuale dhe janë përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 16. Kualiteti i ujit

KRU	Përshtatshmëria e kualitetit të ujit 2023 (%)	
	Testet kimiko-fizike	Testet bakteriologjike
PRN	97.4%	98.7%
PZ	98.7%	99.3%
PE	87.1%	99.4%
MIT	98.2%	98.8%
GJA	98.0%	98.8%
FE	94.8%	87.5%
GJI	99.3%	99.8%

Në nivel sektori:

- Përshtatshmëria bakteriologjike është 98.7%.
- Përshtatshmëria fiziko-kimike 97.4%.

Shenim: Kualiteti i ujit që furnizohet tek konsumatorët sipas UA 10/2021 është përgjegjësi ekskluzive e IKSHPK nga aspekti i monitorimit operacional dhe monitorimit të përputhshmërisë, përfshirë edhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj ofruesve të shërbimit tek të cilët ka mos përputhje me standardet e aprovuara. Nga perspektiva e ARRU është evidente që kualiteti i ujit ka një përkeqësim tek KRU PRN (pjesa e testeve fiziko-kimike), tek KRU HDI (poashtu pjesa e testeve fiziko-kimike) dhe tek KRU BIF (pjesa e testeve bakteriologjike). Në nivel sektori vërehet një përkeqësim i përputhshmërisë me standardet e aprovuara të testeve fiziko-kimike.

### Prodhimi, faturimi dhe uji i pa faturuar (UPF)

Prodhimi i ujit i referohet vëllimit të ujit të përpunuar që është futur në sistem, faturimi i ujit nënkupton ujin që iu është faturuar (shitur) konsumatorëve, ndërsa uji i pa faturuar nënkupton vëllimin e ujit që nuk është faturuar dhe që nuk sjellë të ardhura, i njohur si humbjet e ujit. Në figurën 3 është paraqitur vëllimi i ujit të prodhuar, të faturuar dhe i pafaturuar për vitin 2017 ... 2023.

Shenim: Vëllimi i ujit të prodhuar, rrjedhimisht edhe uji i pafaturuar i prezantuar në figurën 3 mund të mos jenë plotësisht të saktë, pasi raportimi i saktë dhe me matje i ujit të prodhuar tek 7 KRU ka filluar nga prilli 2023, ndërsa KRU Hidrodrini ka filluar së raportuari me matje nga tetori 2023, për shkak të vonesës së instalimit të ujëmatësve në vendburime.




Figura 3. Uji i prodhuar, faturuar dhe i pa faturuar (humbjet e ujit) në nivel sektori

Në vitin 2023 ka përqesim të ujit të pafaturuar (ujit të humbur) për arsye se të gjitha KRU-të nga prilli 2023 raportojnë për ujin e prodhuar sipas matjes, bazuar në vendimin e ARRU-së që të gjithë vendburimet të kenë të instaluar ujëmatës funksional.

Uji i pafaturuar i shprehur në % është prezantuar në figurën 4.




Figura 4. Humbjet e ujit sipas regjioneve (%)

Siç mund të vërehet nga figura 4, përveç KRU Bifurkacioni dhe KRU Mitrovica që kanë mbajtur humbjet e ujit në nivel të njëjtë me planifikimet për vitin 2023, tek KRU-të tjera ka pasur rritje të ndieshme të humbjeve pas fillimit të raportimit të ujit të prodhuar sipas matjes.




Figura 5. Uji i pa faturuar për sektorin për vitet 2010...2023

Në nivel sektori gjatë vitit 2023 ka pasur rritje të UPF për 7 % krahasuar me vitin paraprak (nga 54% në 61%).

Për të pasur një pasqyrë rreth kompleksitetit të humbjeve të ujit dhe për të krahasuar nivelin e humbjeve të ujit në Kosovë me shtetet e regjionit (Ballkan) dhe disa nga shtetet e BE, në tabelën 17 janë prezantuar të dhënat për humbjet e ujit.

Tabela 17. Norma e UPF nëpër shtetet e regjionit dhe të BE

Shtetet e regjionit	UPF (%)	Shtetet e evropiane	UPF%
Shqipëria	65%	Gjermania	10%
Maqedonia e Veriut	62%	Finlanda	17%
Mali i Zi	68%	Polonia	25%
Bosna e Hercegovina	45%	Austria	15%
Serbia	42%	Suedia	17%
Kosova (2023)	61%	Çekia	20%
		Norvegjia	20%
		Belgjika	19%
		Bullgaria	61%
		Rumania	53%
		Italia	39%
		Franca	25%
		Mbretëria e Bashkuar	18%

### Mbulimi me shërbime të ujit dhe ujërave të ndotur

Aktualisht vetëm 79% e popullatës së Kosovës furnizohet me ujë të pijshëm nga kompanitë e licencuara, pjesa tjetër e qytetarëve apo vendbanimeve furnizohen me ujë përmes puseve private apo sisteme ujë-furnizuese që menaxhohen nga komuniteti apo nga komunat, e që ende nuk janë integruar në strukturat regjionale të KRU-ve. Regjionet që kanë mbulueshmërinë më të ulët me shërbime të ujit të pijshëm janë regjioni i Gjilanit 61%, regjioni i Prizrenit me 66%.

Integrimi i sistemeve ekzistuese rurale të furnizimit me ujë në kuadër të KRU-ve do ta ngriste dukshëm nivelin e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe njëkohësisht do të siguronte që mirëmbajtja e

infrastrukturës të jetë në nivel më të mirë, ndërsa kualiteti i ujit të konsumuar të jetë më i sigurtë dhe më i kontrolluar.




Figura 6. Mbulueshmëria me shërbime të ujit të pijshëm

Për sa i përket mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura, situata është edhe më e rëndë; në nivel sektori mbulueshmëria është 65%, ndërsa mbulueshmëri më të ulët kanë regjioni i Pejës me 45%, regjioni i Gjilanit me mbulueshmëri 50% dhe regjioni i Mitrovicës me mbulueshmëri 60%. Duhet potencuar se ka sisteme të kanalizimit në zonat rurale që ende nuk janë të integruara në kuadër të KRU-ve.




Figura 7. Mbulueshmëria me shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotur

Përpunimi i ujërave të ndotur është proces që ka filluar së voni në Kosovë; prej komunave të mëdha aktualisht vetëm në Prizren, Pejë dhe Gjakovë janë ndërtuar impiantet e përpunimit të ujërave të ndotur, përfshirë edhe disa zona rurale. Në proces të hartimit të studimeve të fizibilitetit dhe tenderimit janë

impiantet për komunat e Gjilanit, Mitrovicës dhe Prishtinës. Mbulueshmëria me shërbime të përpunimit të ujërave të ndotur është si në vijim:




Figura 8. Mbulueshmëria me shërbime të përpunimit të ujërave të ndotur

### Numri i konsumatorëve

Nga figura 9 shihet një rritje e shpejtë e numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit, më tepër se dyfishim i numrit të konsumatorëve për 13 vite. Është e qartë se këtë trend të shpejtë të rritjes së numrit të konsumatorëve nuk po mund ta përcjellin KRU-të me infrastrukturë adekuate dhe me nivel të shërbimeve që iu ofrojnë konsumatorëve.

Nëse ky trend i këtillë i rritjes së numrit të konsumatorëve do të vazhdojë, është vështirë e pritshme që KRU-të të mund të ofrojnë burime të mjaftueshme për të gjithë konsumatorët brenda zonës së tyre të shërbimit.




Figura 9. Trendi i rritjes së numrit të konsumatorëve përgjatë viteve

### Efiçienca e faturimit dhe arkëtimit

Efikasiteti i faturimit dhe arkëtimit në nivel të sektorit për 5 vitet e fundit është përmbledhur në tabelën 18.

Tabela 18. Përmbledhje e të dhënave të faturimit dhe arkëtimit për sektorin

Viti	Faturimi (Euro)	Arkëtimi (Euro)	Arkëtimi/Faturimi
2019	37,014,636	33,204,512	90%
2020	36,028,831	30,371,368	84%
2021	37,555,661	35,614,516	95%
2022	39,331,433	36,197,211	92%
2023	40,314,299	40,784,705	101%

Shkalla e arkëtimit për periudhën 2010-2023 është paraqitur në figurën 10.






Figura 10. Trendi i arkëtimit përgjatë viteve

Për dallim nga vitet paraprake ku shkalla e arkëtimit ka qenë relativisht e ulët, duket që në vitin 2023 KRU-të kanë qenë shumë më aktive në detyrimin e konsumatorëve për të paguar faturat e ujit. Kjo ka rezultuar me rritje të arkëtimit në 101% krahasuar me vlerën e ujit të faturuar. Shkalla e arkëtimit prej 101% tregon që kompanitë kanë mbledhur edhe borzje të vjetra si rezultat i shfrytëzimit të mekanizmit të përmbauesve privat në arkëtimin e borzjeve aktuale dhe të vjetra.

### Struktura e shpenzimeve operative

Kontrolli i koston operative është shumë i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve. Dy nga kategoritë kryesore të shpenzimeve janë pagat dhe energjia. Në vitin 2020 këto dy kategori përbënin rreth 79% të shpenzimeve totale operative, në vitin 2021 përbëjnë 76%, e në vitin 2022 përbëjnë 78% të totalit të shpenzimeve operative. Pjesëmarrja e shpenzimeve operative për vitin 2020, 2021 dhe 2022 është dhënë në figurat 11, 12 dhe 13.






Figura 11, 12 dhe 13. Struktura e shpenzimeve operative

Në tabelën 19 janë përmbledhur të dhënat krahasuese të pjesëmarrjes së shpenzimeve të personelit në totalin e shpenzimeve operative për Kosovë dhe në disa shtete të Evropës.

Tabela 19. Krahasimi i shpenzimeve të personelit për disa shtete të rajonit

Vendet e Rajonit	Viti	Shpenzimet e personelit (%)
Kosova	2022	60%
Shqipëria <sup>1</sup>	2020	43% <sup>2</sup>
Maqedonia e Veriut	2016	54%
Mali i Zi	2020	82%
Bosnja e Hercegovina	2020	59%
Serbia	2020	47%
Kroacia	2015	39%
Bullgaria	2015	37%
Rumania	2020	50.5%
Anglia dhe Uells	2020	20%
Slovakia	2013	31.5%

### Efikasiteti i stafit të KRU-ve

Tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt i angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit, për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve. Sa më e ulët të jetë ky koeficient, tregon efikasitet më të madhe të stafit të KRU-së.

<sup>1</sup> Informacionet e marra nga Raporti i Performancës së ERRU për vitin 2020.




Figura 14. Efiqasiteti i stafit sipas regjioneve

Për sa i përket kompanive individuale, shihet që KRU Gjakova, KRU Bifurkacioni, KRU Hidroregjioni Jugor dhe KRU Mitrovica kanë koeficient > 5 për sa i përket efiqasitetit të stafit, ndërsa KRU Hirdrodrini, KRU Hidromorava dhe KRU Prishtina kanë koeficient < 5 për sa i përket efiqasitetit të stafit. KRU Prishtina me koeficient 3.51 është dukshëm nën mesataren e sektorit, pjesërisht mund të shpjegohet me numër shumë të madh të objekteve banesore të ndërtuara, ku secila njësi banesore (apartament) brenda një objekti banesor regjistrohet si konsumatorë i ri.

Efiqasiteti i stafit për periudhën 2010-2023 është paraqitur në figurën 14.




Figura 15. Efiqasiteti i stafit sipas viteve

Në nivel sektori vërehet një trend pozitiv për sa i përket këtij treguesi të performancës, përmirësimi i këtij koeficienti vjen kryesisht si rezultat i rritjes së numri të konsumatorëve të regjistruar në zonën ekzistuese të furnizimit.

Ndërsa krahasimi i efikasitetit të stafit në Kosovë me shtetet e regjionit është paraqitur në tabelën 20.

Tabela 20. Krahasimi i efikasitetit të stafit për disa shtete të regjionit

Shteti	Viti	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)
Kosova	2023	4.53
Shqipëria	2020	5
Maqedonia	2016	3
Mali i Zi	2020	5
Bosnja e Hercegovina	2020	7
Serbia	2020	4
Kroacia	2015	3

Praktikat e mira ndërkombëtare sugjerojnë një normë më të ulët se 5 punëtorë që ju shërbejnë 1000 konsumatorëve; norma më e lartë se 5 tregon mbi punësim.

### Norma e mbulimit të punës

Norma e mbulimit të punës matë aftësinë e një kompanie për të mbuluar kostot operative nga të ardhurat operative. Kjo do të thotë se menaxhimi i qëndrueshëm financiar kërkon që ky raport të jetë më i lartë se 1. Raporti llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat operative me kostot operative, përfshirë subvencionin por nuk përfshin mirëmbajtjen kapitale dhe provizionimin e borxheve të këqija.




Figura 16. Norma e mbulimit të punës

Nga figura 16 shihet se KRU PRN dhe KRU HMV kanë performuar mirë dhe kanë trend rritës të normës së mbulimit të punës, KRU HRJ, KRU GJA, KRU BIF, KRU HDI edhe pse kanë normën e mbulimit të punës > 1, trendi ka qenë zvogëluar krahasuar me vitin e kaluar. Vlen të theksohet se KRU Mitrovica ka rritje të normës në 1.1; megjithatë duhet të kemi parasysh se KRU Mitrovica nuk arkëton fare për ujin që e furnizon për komunitet në veri të Kosovës.

## SHTOJCA 2: TARIFAT PËR UJË DHE UJËRA TË NDOTUR

Në tabelën në vijim janë dhënë tarifat për ujë dhe ujëra të ndotur për të gjitha KRU-të dhe kategoritë e konsumatorëve, përfshirë edhe një krahasim me shtetet e regjionit (për disa qytete).

Tabela 21. Përmbledhje e tarifave të aprovuara me proces tarifor 2022-2024

Kompania	Konsumatorët	Tarifat	Njësia	2022	2023	2024
PR	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.44	0.44	0.44
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.06	0.06	0.06
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.67	0.67	0.67
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.13	0.13	0.13
PZ	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.38	0.38	0.38
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.57	0.57	0.57
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.32	0.32	0.32
PE	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.25	0.25	0.25
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.31	0.31	0.31
MIT	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.36	0.36	0.36
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.09	0.09	0.09
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.54	0.54	0.54
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.20	0.20	0.20
GJA	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.56	0.56	0.56
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.30	0.30	0.30
FE	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.10	0.10	0.10
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.55	0.55	0.55
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.22	0.22	0.22
GJI	Shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.35	0.35	0.35
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.08	0.08	0.08
	Jo-shtëpiak	Ujësjiellës	EUR/m <sup>3</sup>	0.52	0.52	0.52
		Kanalizim	EUR/m <sup>3</sup>	0.17	0.17	0.17

## Krahasimi i tarifave për shërbimet e ujit në Evropë

Tabela 22. Pasqyrë e tarifave vëllimore për disa shtete të Evropës

Shteti	Tarifa (Euro/m <sup>3</sup> )
Moldavia	0.46
Kosova	0.58
Maqedonia e Veriut	0.59
Shqipëria	0.81
Ukraina	0.95
Bullgaria	1.45
Rumania	1.71
Spanja	1.81
Lituania	2.36
Slovenia	2.37
Sllovakia	2.44
...	
Gjermania	4.73
Norvegjia	4.78
Skocia	4.95
Belgjika	4.99

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Ali Pashë Tepelena, Nr. 1

E-mail: [info@arru-rks.org](mailto:info@arru-rks.org)

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>